



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.04.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit.
2. Seancë dëgjimore me kryetarin e Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë lidhur me raportimin vjetor të ERE-s për vitin 2021 (*Komision përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Laert Duraj, Fadil Nasufi, Tatiana Piro, Luljeta Bozo, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Benet Beci, Lefter Gështenja, Zef Hila, Ramadan Likaj, Xhelal Mziu, Agron Duka, Nusret Avdulla dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Ismet Beqiraj, Anduel Tahiraj, Rrahman Rraja, Flamur Hoxha dhe Fatjon Veizaj.

Të ftuar:

Petrit Ahmeti – Kryetar i Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë.

Raimonda Islamaj – Anëtare e Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë.

Maksim Shuli – anëtar i Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë.

Elton Radheshi – sekretar i Përgjithshëm i Entit Rregullator të Energjisë.

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Sot në rendin e ditës, sikurse jeni në dijëni, kemi një seancë dëgjimore me kryetarin e Bordit Drejtues të Entit Rregullator të Energjisë në lidhje me raportin për vitin 2021 të ERE-s.

Të ftuar kemi zotin Petrit Ahmeti, kryetar i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë, zotin Maksim Shuli, anëtar bordi dhe zotin Elton Radheshi, sekretar i Përgjithshëm.

Mirë se erdhët!

Relator është zoti Anduel Tahiraj, por për një arsye shëndetësore nuk ndodhet sot prezent. Kështu që relativisht do ta bëj unë.

Atëherë, fjala për ju, zoti Ahmeti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Xhelal Mziu – Marr shkas nga mbledhja që patëm ditën e djeshme. Në fakt, është bërë e udhës që diktohem nga mbledhjet partiake që bëhen në këtë komision.

Nuk është hera e parë që e ngremë zërin, e kemi ngritur edhe herë të tjera, por çudia ndodh që edhe kur shtyhet orari i mbledhjes, përsëri vijmë e presim nja 30-40 minuta e, ndërkohë, detyrohemi të largohemi, sepse bëhet zgjedhja e Presidentit. Madje, ka edhe një absurd: këtë bëhet zgjedhja e Presidentit, këtë thuhet që do të vazhdojmë negociatat... Por mua nuk më duket normale që në një institucion kaq serioz sa është komisioni apo grupi parlamentar, apo edhe vetë parlamenti, të shkojë në këtë lloj situatë, aq më tepër kur opozita ka ofruar gjatë gjithë kohës kompromisin. Madje, edhe në ato raste kur keni pasur mungesa e të tjera, keni shtyrë edhe votimet për ditët e tjera.

Ndërkohë, vazhdoni me ngut, në mënyrë të njëanshme, duke tejkaluar çdo afat kohor të organizimit të komisionit, madje fusni edhe në seancën plenare të ditës së nesërme tre akte normative, të cilat kanë vërtet një efekt të jashtëzakonshëm, por që nuk u bënë pjesë e debatit në këtë komision.

Kështu që mua nuk më duket normale, aq më tepër edhe për shkak të luajalitetit që ne kemi treguar gjatë gjithë kësaj periudhe.

Arben Pëllumbi – Ju falënderoj, zoti Mziu!

Në fakt, keni të drejtë për dje. Unë edhe në mbledhjen që zhvilluam dje e përmenda këtë fakt. Ne jemi pjesë e këtij komisioni, por njëkohësisht jemi pjesë edhe e grupeve tona

parlamentare. Unë ju falënderoj për faktin se ju pranuat që ne ta spostojmë orarin, por aktiviteti ynë brenda grupit mori më shumë kohë nga sa ishte parashikuar.

Çështja që ne kishim dje ishte për seancën e ditës së enjte dhe duhej të shqyrtoheshin patjetër dje. Shpresojmë që herë të tjera të organizohemi pak më mirë me oraret, që të mos kemi përplasje të kësaj natyre. Por kjo ndodhi pikërisht sepse dita e hënë ishte pushim dhe ditën e martë u ngjeshën të gjitha aktivitetet, qofshin këto të grupit parlamentar, qofshin të komisionit.

Gjithsesi, do të përpiqemi të mos e kemi më këtë përplasje dhe të jemi korrektë në lidhje me atë çfarë vendosim për të bërë në komision.

Vazhdojmë me zotin Ahmeti.

Fjala për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon): Zoti kryetar, mundem?

Po, urdhëroni.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zoti kryetar!

Gjithsesi, për të mos e vazhduar më gjatë këtë pjesë, unë do ta quaja krejt normale që të paktën nga ana juaj të kishte një njoftim të dytë që të shtyhej mbledhja e këtij komisioni. Pra, ne të kishim një njoftim si komision. Ne nuk e kemi pasur një njoftim të dytë për shtyrjen e mbledhjes së komisionit. Pra, u shty nga ora 10, në 11, le të vendosej që do ta zhvillojmë në orën 13 apo në 14. Pastaj, ishte tjetër gjë pjesëmarrja, do të vinim ose jo ne.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Fjala për ju, zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti – I nderuar zoti kryetar i komisionit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Në emër të Entit Rregullator të Energjisë, paraqes para jush raportin vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe mbi veprimtarinë e ERE-s për vitin 2021.

Në këtë raport, ndër të tjera, është synuar dhënia e një pasqyre të plotë dhe sa më të detajuar mbi gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në vendin tonë.

Po ashtu, pjesë përbërëse e këtij raporti është edhe një informacion i detajuar dhe i përditësuar mbi aktivitetin e shoqërive, të cilat operojnë në këta dy sektorë të rëndësishëm të vendit tonë.

Theksoj se një pjesë e mirë e vitit 2021, sikurse jemi dëshmitarë, ka qenë e mbushur me problematika të veçanta shëndetësore dhe humanitare, të cilat patën ndikimin e tyre në

sektor. Megjithatë, nga ana jonë është bërë i mundur funksionimi normal i aktiviteteve të ERE-s në përmbushjen e detyrave dhe të ligjeve të sektorit.

Përgjatë vitit të kaluar sektori i energjisë ka pasur një qëndrueshmëri për sa i takon aktivitetit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mbajtur dhe ruajtur parametra të qëndrueshëm operimi, sigurie dhe cilësie furnizimi të konsumatorëve.

Në këtë prizëm, për t'u përshtatur me situatën emergjente, e cila u ndikua edhe nga rritja e çmimeve të energjisë elektrike në tregjet rajonale, nga ana jonë janë marrë masat për mbarëvajtjen e punës dhe monitorimin e zbatimit të planit të masave që përputhej me shpalljen e fatkeqësisë natyrore.

Për këtë arsye konsumatorët, të cilët nga 1 janari i vitit 2022, dolën në treg të lirë sipas parashikimeve të ligjit të sektorit nëpërmjet kontratës midis KESH sh.a. dhe FSHU-së (Furnizimit të Shërbimit Universal) për furnizimin e konsumatorëve të lidhur në tension 20, 10 dhe 6 kilovolt, është nënshkruar kontrata e shitjes për furnizimin, si shërbimi i mundësisë së fundit me një çmim më të ulët sesa niveli i tregut. Kjo kontratë mundëson shitjen e energjisë elektrike te këta konsumatorë me një çmim më të ulët sesa tregu, duke zbutur kështu efektet e rritjes së çmimeve në treg të blerjes së energjisë elektrike.

Nxitja e investimeve në ndërtimin e impianteve gjeneruese fotovoltaike apo eolike për vetëkonsum do të ishte një masë e cila do të ulte konsumin e përdorimit të energjisë elektrike te konsumatorët.

Gjithashtu, themelimi i bursës së energjisë elektrike ALPEX në tetor të vitit 2020, përzgjedhja me sukses e ofertuesit të shërbimit të fundit të vitit 2021 dhe nënshkrimi i marrëveshjes me ofertuesin e shërbimit në fillim të vitit 2022 janë hapa tejet të rëndësishme për hapjen e tregut dhe bashkimin e tregjeve me Kosovën, si dhe për angazhimet e ndërmarra në rang ndërkombëtar nga ana e Shqipërisë si palë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe bashkimit të tregjeve në Tregun e Përbashkët European.

Në këtë kuadër, u nënshkrua marrëveshja kuadër me rregullatorin e Kosovës, OST, dhe ALPEX për hapat që duhen ndërmarrë për operimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike midis të dyja vendeve.

Gjithashtu, u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit me Rregullatorin e Kosovës për njohjen reciproke të licencave në fushën e energjisë elektrike ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Fokusi ynë në bashkëpunim me aktorët kosovarë mbetet operimi sa më i shpejtë i tregut të përbashkët dhe përgatitja e kuadrit rregullator për të mundësuar funksionimin e tij sa më të shpejtë, sidomos në kohët e krizës energjetike, ku sistemet tona komplementare mund

të shërbejnë në uljen e kostove financiare të prodhimit dhe të furnizimit të konsumatorëve të të dyja vendeve.

Përgjatë vitit 2021 kanë hyrë në prodhim gjithsej 18 impiante me një kapacitet të instaluar prej rreth 97 megavatë, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2021 sasinë prej 79971 megavatorë. Prodhimi i energjisë elektrike, i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2021, zë gati 1% të prodhimit total vendas për këtë vit.

Prodhimi total neto vendas i energjisë elektrike, i realizuar për vitin 2021, është 8,9 megavatorë, nga i cili 5,3 terravatorë ose 596% u prodhua nga centralet në zotërim të shoqërisë publike të prodhimit KESH dhe 3,6 teravatorë ose 40,4% u prodhua nga centralet e tjera.

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike, të regjistruar në vend, rezulton se në vitin 2021 me sasinë e prodhuar prej mbi 8,9 terravatorë është mbi mesataren e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009-2021.

Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009-2021 është rreth 6 terravatorë dhe prodhimi i realizuar për vitin 2021 rezulton të jetë rreth 2,8 terravatorë ose 47,5% më shumë sesa mesatarja e prodhimit për periudhën e sipërcituar.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike të instaluar në vendin tonë deri më 31 dhjetor 2021 ishte rreth 2605 megavatë. Ky kapacitet ka pasur një nivel në rritje në vitin 2021 me rreth 97 megavatë, krahasuar me vitin paraardhës.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2021 është rreth 2264 megavatë dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë rreth 8 terravatorë.

Nga balanca neto e shkëmbimit të energjisë elektrike për vitin 2021, si eksport prej rreth 548 gigavatorësh, rezulton se diferenca e eksportit të jetë realizuar në sasinë prej 2800 gigavatorë dhe importit të realizuar në vlerën 2252 gigavatorë. Kjo për faktin se sistemi elektro-energjetik shqiptar e bazon prodhimin e energjisë elektrike në burimet hidrike, ku për periudha me reshje arrin të eksportojë energji elektrike dhe në periudhën e thatë, gjithashtu, gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2021 u detyrua të realizojë import të energjisë elektrike për të mbuluar kërkesën në vend. Kjo për faktin se profili i prodhimit në vendin tonë nuk përkon gjithmonë për të njëjtat periudha me profilin e konsumit në vend, gjë për të cilën do të kontribuonte pozitivisht diversifikimi i burimeve gjeneruese të energjisë elektrike.

Konsumi total për energjinë elektrike në vitin 2021 arriti në vlerën mbi 8,4 terravatorë. Krahasuar me vitin 2020, vërehet një rritje e ndjeshme e konsumit të energjisë elektrike në vend me rreth 826 gigavatorë.

Rritja e konsumit të energjisë elektrike për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, shkon deri në rreth 11%. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se konsumi i energjisë elektrike, i realizuar për vitin 2021, është rreth 20% më i lartë sesa konsumi mesatar shumëvjeçar për periudhën 2004-2021, sipas të dhënave historike. Kjo rritje e konsumit të energjisë elektrike, në gjykimin tonë, vjen edhe si rezultat i ndryshimeve të strukturës së ekonomisë apo edhe hapjes së saj pas mbylljes si efekt i pandemisë Covid-19 përgjatë vitit 2021.

Humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2021 arrijnë në masën 20,62%, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve, krahasuar edhe me vitin 2020 prej 21,48%. Për vitin 2021 humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë në vlerën rreth 1,78 terravatorë.

Niveli total i arkëtimeve, i raportuar nga OSSH-ja, është në vlerën 97,4% kundrejt energjisë elektrike të faturuar. Ky tregues duket i konsoliduar tashmë, pasi përgjatë viteve të fundit ka qenë në nivelin mbi 95%. Kjo shifër është ndër aspektet kryesore të punës që tregon për stabilitetin e Operatorit të Shpërndarjes në këtë fushë.

Numri i përgjithshëm i klientëve të energjisë elektrike, sipas raportimeve të FSHU-së për vitin 2021 është rreth 1279460 dhe, krahasuar me vitin 2020, vihet re një rritje e numrit të tyre në rreth 6460 konsumatorë.

Edhe për vitin 2021 pjesën më të madhe të klientëve të Furnizimit të Shpërndarjes e zënë klientët familjarë që shkojnë në rreth 86% të numrit total të klientëve. Konsumi i klientëve familjarë për vitin 2021 zë rreth 36% të konsumit total, shifër kjo më e ulët e krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2020, i cili ishte në masën 39%, kjo si shkak edhe i ndryshimit të strukturës së konsumit.

Duhet pasur në konsideratë se vitet 2020 dhe 2021 kanë qenë atipike lidhur me ecurinë e çmimeve të tregut të energjisë elektrike, pasi në kushtet e ndikimit të pandemisë Covid-19 dhe mbylljes së ekonomisë pati një ulje të kërkesës, ndërkohë që përgjatë gjashhtëmujorit të dytë të vitit 2021 pati një rritje të theksuar dhe të pazakontë të çmimeve të energjisë elektrike në rajon, ndikuar kjo nga disa faktorë, si: hapja e ekonomive, rritja e kërkesës për energji elektrike, rritja e çmimeve të gazit natyror në rajon dhe më gjerë.

Për sa i përket çmimit vjetor që u është paguar prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2021, ai ka rezultuar i njëjtë me vitin 2020 në vlerën 7,4 lekë për kilovatorë. Bëhet fjalë këtu për hidrocentralet e vegjël kryesisht, për të cilët ata kanë të drejtën të operojnë me çmimet e miratuara nga ana e Entit Rregullator.

Viti 2021 ka sjellë një sërë zhvillimesh të rëndësishme në tregun e energjisë elektrike në vendin tonë.

Që nga 1 prilli i vitit 2021 operon tregu i balancimit të energjisë elektrike, bazuar në rregullat e miratuara nga ERE me vendimin nr. 106, datë 2.07.2020. Operimi i plotë i këtij tregu u mbështet edhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në Vjenë, i cili e konsideronte këtë zhvillim si një hap të rëndësishëm në reformën e sektorit të energjisë në vendin tonë.

Operimi i suksesshëm i këtij tregu nga palët, megjithëse pati efektet e veta në çmimin e disbalancave, mundësoi sigurinë e furnizimit në tregun e parregulluar shqiptar. Mirëfunksionimi i tij nuk rrezikoi ekspozimin financiar të OST-së, fakt i cili ka ndodhur në vendet e tjera të rajonit, si në Maqedoninë e Veriut, në Bosnjë-Hercegovinë apo edhe në Serbi, duke krijuar në to efekte financiare për sistemet e transmetimit, të cilat, për shkak të rritjes së çmimeve, mbetën të zbuluara financiarisht nga operatorët të cilët falimentuan ose nuk arritën të mbulonin kostot e këtij tregu.

Po në vitin 2021 është miratuar rregullorja për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë elektrike (REMIT), e cila transponon rregulloren e REMIT-it, siç është miratuar dhe përshtatur për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë dhe ka si qëllim të përcaktojë kriteret që ndalojnë praktikën abuzive që mund të ndodhin dhe të prekin tregjet e energjive me shumicë. Kjo rregullore ndihmon në funksionimin e duhur dhe transparent të këtyre tregjeve, duke marrë parasysh karakteristikat e tyre specifike.

Në lidhje me sektorin e gazit natyror, përgjatë vitit 2021 ka vijuar puna për miratimin e akteve rregullatore në këtë sektor.

Po ashtu, duke nisur nga data 15 nëntor 2020 e në vazhdim, përgjatë vitit 2021 TAP-i operon si operator i pavarur i sistemit të transmetimit ose me të drejta të plota.

Viti 2021 shënon edhe fillimin e periudhës së përjashtimit 25-vjeçar nga aksesimi i palëve të treta, rregullimin e tarifës dhe veçimin e pronësisë që i është dhënë TAP-it nga Komisioni Europian dhe nga autoriteti rregullator shqiptar, së bashku me autoritetet rregullatore greke dhe italiane.

Që nga fillimi i vendosjes në funksion në datën 15 nëntor 2020, falë bashkëpunimit të fortë ndërmjet dispeçerimit komercial dhe fizik, nominimet e transportuesve për gazsjellësin TAP janë përpunuar menjëherë dhe dërgesat e gazit janë sjellë me sukses deri në pikat e interkonjeksionit me sistemin e transmetimit kombëtar në Itali dhe në Greqi, deri tani rrjetet SRK dhe DESFA.

Si rrjedhojë, TAP-i ka transportuar rreth 8 miliardë metra/kub gaz nga kufiri greko-turk, ku rreth 8 miliardë metra/kub gaz janë transportuar në Itali përmes Shqipërisë dhe 1,2 miliardë metra/kub gaz, të cilat furnizohen në Greqi.

Në datën 6.07.2021 TAP AG, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri dhe "Albgaz sh.a." nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi dhe dorëzimi për objektin e seksionit jugor në Fier. Sipas marrëveshjes, pasi të përfundojë objekti në këtë seksion, ai do t'i dorëzohet shtetit shqiptar dhe do të zotërohet, do të menaxhohet dhe do të vendoset në funksion nga qeveria shqiptare.

Në të njëjtën kohë ka filluar testimi i tregut për zgjerimin e kapaciteteve. Ky mekanizëm synon zgjerimin dhe për t'i dhënë mundësinë çdo pale të interesuar për të paraqitur një kërkesë për lidhjen me gazsjellësin TAP, duke përfshirë edhe territorin e Shqipërisë.

TAP-i ka organizuar testimin e parë në treg në korrik të vitit 2019 dhe ka filluar një tjetër testim tregu në korrik të vitit 2021. Në vijim të këtij të fundit, gjatë fazës jodetyruese të shprehjes së interesit, TAP-i ka marrë një interes të konsiderueshëm me kërkesa për kapacitetet dhe lidhje me Shqipërinë nga disa kompani serioze në Shqipëri.

Të nderuar deputetë,

Puna jonë ka pasur dhe do të ketë si qëllim kryesor zhvillimin në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në përputhje me kërkesat, rregulloret dhe legjislacionet, të cilat duhet të përputhen plotësisht me ato të Bashkimit Europian. Këto zhvillime, ndër të tjera, kërkojnë që ERE të zhvillohet si një institucion me kapacitete teknike të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme.

Enti Rregullator i Energjisë ka pasur dhe do të ketë si mision dhe në fokusin e tij kryesor kryerjen e shërbimeve të sigurta dhe të besueshme për klientët, bazuar në kosto sa më të drejta dhe të arsyeshme për të licencuarit.

Sa më sipër, është reflektuar në vendimmarrjen për përcaktimin e tarifave dhe të çmimeve të energjisë elektrike.

Për vitet e ardhshme objektivat e ERE-s do të vijojnë të orientohen drejt plotësimin të legjislacionit me aktet përkatëse, e lidhur kjo ngushtë edhe me përgatitjen për implementimin e paketës së katërt legjislative për energjinë e pastër, monitorimin dhe liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike dhe të operimit të suksesshëm të bursës së energjisë elektrike, si dhe zhvillimit më tej të kuadrit rregullator për sektorin e gazit natyror, si një mundësi që i jepet vendit tonë nga përfundimi i projektit TAP.

Në këtë prizëm ERE mbetet tërësisht e angazhuar për një bashkëpunim edhe më të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vjenë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës, si dhe me të gjithë aktorët e tjerë të sektorit të energjisë në vend dhe më gjerë.

Me gjithë arritjet apo përmirësimet e përshkruar në këtë raport, puna jonë në vijim do të fokusohet, ndër të tjera, edhe në çështjet që lidhen me:

zbatimin e rregullores së transparencës dhe integritetit në tregun me shumicë të energjisë;

monitorimin e vazhdueshëm dhe implementimin e ndarjes funksionale të operatorëve të OSSH-së;

zbatimin e planit strategjik për reformat në sektorin elektro-energjetik;

impaktin e burimeve të rinovueshme në treg;

zbatimin e strategjisë për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë;

paketën e energjisë së pastër;

zbatimin e mekanizmit të tregut të balancimit dhe garantimin e shërbimeve ndihmëse;

platformën *online* të krahasimit të çmimeve të furnizuesve në treg të parregulluar;

vijimin e punës për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike me Kosovën dhe bashkimin e tregjeve me vende të tjera të rajonit;

liberalizimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike dhe operimin e bursës së energjisë;

krijimin e tregut rajonal të garancive të origjinës;

zbatimin e strategjisë 3-vjeçare së rregullatorit për vitet 2022-2023 dhe azhurnimin e saj.

Një vëmendje të rëndësishme dhe prioritare në punën tonë ka pasur edhe transparenca e sektorit. Në kuadër të transparencës, ky raport vjetor, si gjithmonë, do të jetë në dispozicion të të gjitha institucioneve, investitorëve, por edhe konsumatorëve që janë të interesuar në faqen zyrtare të Entit Rregullator.

Në fund, dëshiroj të falenderoj bordin dhe të gjithë stafin e ERRE-s, si dhe të gjitha institucionet për mbështetjen dhe bashkëpunimin, në mënyrë të veçantë Kuvendin e Shqipërisë, por edhe pjesëtarët e tregut, qofshin këta konsumatorë, qofshin palë të tjera, të cilat, në çdo rast, mendoj se kanë pasur akses të sigurt në praktikën e shqyrtuara dhe miratuara nga ana jonë!

Kjo ishte shkurtimisht një përmbledhje e disa prej drejtimeve kryesore të aktivitetit dhe punës së Entit Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2021 në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. Natyrisht, në këtë raport ne nuk u ndalëm në treguesit që lidhen me aktivitetet e tjera të Entit Rregullator, siç është kujdesi ndaj klientëve apo edhe elemente të tjera, të cilat janë shprehur në mënyrë të sintetizuar edhe në raportin vjetor që ne kemi dorëzuar.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Ahmeti!

Raporti vjetor i Entit Rregullator të Energjisë është paraqitur në Kuvend brenda afatit, në datën 23 mars të këtij viti, dhe është në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar”, si dhe nenin 21, pika 1 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Në përgjithësi raporti respekton vendimet e Kuvendit me nr. 134 të vitit 2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik “. Gjithsesi, kolegët e kanë raportin të plotë, por kanë edhe monitorimin e bërë nga Shërbimi i Monitorimit të Kuvendit.

Unë dua të ndalem shkurtimisht në disa pika, të cilat i konsideroj të rëndësishme në situatën ku ndodhemi, por si fillim, zoti kryetar, kam një vërejtje për raportin. E gjejmë gjithandej të theksuar mungesën e redaktimit të plotë të tij. Kështu që, ju lutem, herë tjetër të jemi pak më të vëmendshëm ndaj kësaj pike.

Nga 13 rekomandimet që ne kemi lënë vitin e kaluar, nga të cilat 5 janë plotësuar plotësisht dhe 8 të tjerat janë plotësuar pjesërisht ose janë në proces, duke pasur parasysh edhe situatën energjetike që po kalon jo vetëm vendi, por e gjithë bota, pika më e rëndësishme që unë besoj se ne duhet të diskutojmë dhe ku institucioni juaj duhet të përqendrohet është çështja e bursës së energjisë ALPEX-it. Në bashkëpunim me rregullatorin e Kosovës janë bërë hapa konkretë për procesin e përzgjedhjes së NEMO-s dhe përafrimin e legjislacionit sekondar midis dy vendeve tona. Ky është një rekomandim i realizuar, por, siç e thashë, duke pasur parasysh situatën në të cilën ndodhemi, mendoj se presioni nga ana juaj për hapjen dhe fillimin real të punës së bursës së energjisë ALPEX do të ndihmonte në mënyrë të drejtpërdrejtë për sigurimin e çmimeve më të favorshme për konsumatorët tanë.

Në këtë kuadër, për rekomandimin që ne kemi lënë për bashkëpunim me Entin Rregullator të Italisë ju keni filluar përpjekje për të bërë të mundur njohjen e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike, pra, NEMO-s, nga komitetet e bursave të vendeve të BE-së, por ky është një proces që duhet të vazhdojë me ritëm më të shpejtë, sepse është e rëndësishme, që krahas fillimit të bursës së energjisë në Shqipëri, të kemi mundësi që kjo bursë të njihet edhe nga operatorët e vendeve të komunitetit të bursave të BE-së.

Për sa i përket pikës që lidhet me OSHEE-në, duke pasur parasysh që është shumë i rëndësishëm liberalizimi i tregut të energjisë elektrike, është parashikuar të merren masa për planin e veprimit dhe ndarjen funksionale të OSHEE-së. Kjo është një çështje që tashmë është realizuar, por vëmendja juaj duhet të vazhdojë të jetë e përqendruar në liberalizimi real të tregut të energjisë elektrike. Besojmë se konkurrenca në këtë treg është e mirëpritur për të

siguruar si shërbim më të mirë ndaj klientit, ashtu edhe çmime më të përshtatshme. Pavarësisht faktit që situata sot është e komplikuar në këtë fushë, besojmë që normalizimi do të vijë shpejt dhe ne duhet të jemi gati në mënyrë që të kemi mundësi të përballojmë këto rekomandime që kemi bërë në lidhje me liberalizimin e tregut.

Ajo çka vazhdoj ta konsideroj të rëndësishme është përpjekja që duhet të vazhdojmë të bëjmë për burimet e energjisë së rinovueshme, qofshin këto të mëdha, qofshin të vogla. Sigurisht, sot kemi dy impiante, ku njëri pritet të fillojë nga puna, kurse tjetri është në proces e sipër, por burimet e vogla të energjisë së rinovueshme kërkojnë një vëmendje të shtuar nga ana juaj për të zgjidhur të gjitha ato problematika, të cilat lidhen me këtë proces dhe që ne i njohim të gjithë.

Nevojitet një plan konkret për këtë punë, sepse, po të kemi parasysh, gjatë vitit 2021, ju e keni shkruar edhe në raport, prodhimi nga këto burime është shtuar nga 32265 megavatorë në 40756 megavatorë, por, duke pasur parasysh totalin prej 8 962 700 megavatësh, është shumë pak në raport me prodhimin nga burimet hidrike, çka tregon se akoma jemi larg diversifikimit të burimeve të prodhimit dhe pavarësisë sonë nga koha.

Ju e përmendët, e keni shkruar gjerësisht edhe në raport, që një pikë tjetër e rëndësishme është edhe çështja e rrjetit të transmetimit të shpërndarjes së gazit. Tashmë TAP-i ka filluar furnizimin, ndaj ne do të duhet të ecim në rrugën tonë për gazifikimin e vendit. Nëse është e mundur, do të dëshiroja ta shikonim këtë gjë jo thjesht për Shqipërinë, por si një zgjidhje rajonale, për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor. Ndoshta këtu do t'ju duhet të hyni në kontakt edhe me homologët tuaj për të gjetur më të mirën e mundshme për të gjitha vendet tona, duke pasur parash që gazi vazhdon akoma të konsiderohet një produkt i lejuar i gjelbër dhe një zgjidhje mjaft e mirë për momentin, duke pasur parasysh çmimet e larta të energjisë. Në këtë kuadër, edhe transformimi i TEC-it të Vlorës me gaz të lëngshëm duhet të ketë vëmendjen tuaj.

Nga ana tjetër, kemi filluar një proces (ky është një rekomandim në proces dhe do të vazhdojë të jetë në proces), i cili ka të bëjë me pikat e karikimit të mjeteve elektrike, që ju e keni mbështetur. Mjetet elektrike po fillojnë të shtohen. Të gjitha kompanitë e rëndësishme po fillojnë të kanalizojnë prodhimet e tyre edhe në këtë sektor, por do të duhet që ne të jemi të përgatitur, sepse është akoma shumë e vështirë të kesh një mjet elektrik duke pasur parasysh problemet e karikimit apo edhe të tarifimit të këtij procesi. Kështu që, të mos mendojmë se jemi shpejt. Situatat ku ndodhemi do ta sjellin imediate këtë çështje në vitet që vijjnë dhe nuk duhet të na gjejë të papërgatitur.

Sot Tiranës i është shtuar një flotë e re autobusësh elektrikë. Gjithashtu, vazhdon përditë të shtohen

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është shtuar. Pse?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të jemi të përgatitur edhe për këtë gjë.

Në përgjithësi këto gjëra kisha. Besoj se nga diskutimet dhe pyetjet e kolegëve do të trajtojmë edhe çështje të tjera, të cilat ndoshta kanë të bëjnë edhe me sjelljen ndaj konsumatorit apo shërbimin ndaj klientit, që në raport është e shkruar, por edhe ju në fjalën tuaj e thatë se nuk jeni përqendruar në këtë pjesë.

Ju falënderoj!

Kush e do fjalën?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, patjetër.

Baftjar Zeqaj - Ka shumë hidrocentrale të vegjël që, për një arsye apo një tjetër, kanë ndaluar prodhimin, sidomos 2 vjetët e fundit. Ka ndonjë mendim ose strategji për t'i rikthyer në punë, pra, për një rifreskim të lejes së tyre? Unë di që janë shumë dhe që ka kërkesa pranë ministrisë së Energjisë për këtë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjithashtu, ka shumë kërkesa edhe për parqet fotovoltaike. Ka ndonjë strategji apo platformë nga ju ose qeveria shqiptare lidhur me këtë çështje? Cilat do të jenë sipërfaqet dhe vendet? A ka ndonjë studim për këtë punë?

Pyetja tjetër është për vendburimin e gazit në Delvinë, që duhet të ishte vënë në punë gati 1 vit më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendburimi i gazit në Delvinë.

Ka ndonjë bashkëpunim me kompanitë që po punojnë sot në Delvinë, sepse të paktën deri para 1 viti ata nuk ishin të qartë për gazin që do të nxirrin? Punonin për ta vënë në punë si vendburim, por nuk ishin të qartë se çfarë do të behej me gazin që do të nxirrin.

Një vendburim strategjik gazi është edhe Dumrea. A është në vëmendjen tuaj kjo? Këto pyetje kisha.

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Zeqaj!

Kolegë, si doni të procedojmë, të mbledhim të gjitha pyetjet dhe pastaj të marrim përgjigjet apo të marrim përgjigje pas çdo pyetjeje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Ahmeti, vazhdoni me përgjigjet e pyetjeve në mënyrë racionale, që të kenë mundësi të gjithë kolegët të marrin fjalën për të thënë mendimin e tyre.

Petrit Ahmeti – Faleminderit!

Natyrisht, do të mundohemi të jemi sa më racionale, por gjithmonë kur bëhet një pyetje, përgjigja kërkon të jetë sa më shteruese, ndaj ne detyrohemi të zgjatemi duke dhënë edhe argumente të tjera shtesë, me merakun që çdo gjë të sqarohet deri në pikën e fundit.

Për sa u përket rekomandimeve për bursën e energjisë elektrike, është një proces që ne praktikisht e kemi filluar dhe është miratuar një pjesë e mirë e bazës legjislative. Kjo ka të bëjë me një marrëveshje të kohëve të fundit që ne kemi bërë me rregullatorin e Kosovës, sepse mendojmë që ky bashkëpunim do të jetë shumë frytdhënës në lidhje me trajtimin sa më mirë dhe sa më transparent të tregut të energjisë elektrike.

Në lidhje me pyetjen për rregullatorin italian, natyrisht, ne jemi prezentë në bashkimin e rregullatorëve të Mesdheut. Pa dashur të them gjëra të tepërta, personalisht gëzoj pozicionin e presidentit të rregullatorëve të vendeve të Mesdheut. Praktikisht, kemi qenë dhe jemi shumë aktivë në raporte që kemi jo vetëm me rregullatorin italian, por edhe me rregullatorët e vendeve të tjera. Ky është një orientim i direktivave të Bashkimit Europian për të krijuar një treg sa më të konsoliduar dhe sa më bashkëpunues në lidhje me vendet e Mesdheut.

Për sa i përket liberalizimit të tregut që lidhet me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, natyrisht, ne i kemi marrë deri tani vendimet duke përcaktuar bazën legjislative dhe legjislacionin sekondar në lidhje me detyrimin dhe aktivitetet që kanë operatorët që përfaqësojnë tregun e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes. Natyrisht, janë përcaktuar detyra dhe rregullore konkrete të bashkëpunimit midis tyre, si nga pikëpamja teknike ashtu edhe në raportet financiare që ato duhet të kenë midis tyre. Mendoj se viti që vjen është viti i konsolidimit të këtyre raporteve midis strukturave të sektorit të shpërndarjes dhe funksionimit normal të tyre.

Për sa u përket problemeve që lidhen me gazin natyror, në respekt edhe të profilit, unë po ia kaloj fjalën kolegut tim, Maksim Shuli, në lidhje me trajtimin e pyetjeve dhe elementet për të cilat ju kërkuat sqarime.

Maksim Shuli – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen për vendburimin e gazit në Delvinë, faktikisht te ky vendburim kryen punime një firmë private. Pritet që së shpejti kjo të japë një sasi gazi, vetëm një pus

rreth 30 000 metra kub gaz, që po ta konvertojmë janë 30 tonë naftë në 24 orë. Për momentin kjo kompani duhet ta zhvillojë aktivitetin e saj në këtë vendburim. Faktikisht, është një nga vendburimet me potencial për të ardhmen. Shumë shpejt kjo sasi gazi do të vihet në përdorim, por për momentin do të vihet për konsumatorët vetjak rreth e rrotull.

Në studimin e fizibilitetit, që ne kemi bërë, janë 6 projekte prioritare. Një nga projektet prioritare është: nga Fieri deri në Sarandë do të ndërtohet një tubacion, i cili në perspektivë do të bëjë lidhjen e të gjithë Jugut. Siç do të kemi edhe më vonë tubacionin e IAP-it, *Ionic Adriatic Pipeline* nga Fieri deri në Kroaci.

Në lidhje me Dumrenë, faktikisht edhe Dumrea është një vendburim tashmë i vërtetuar, potencial, por para pak kohësh ka mbaruar studimi i fizibilitetit për të bërë ruajtjen nëntokësore të gazit, i cili ka dalë shumë i mirë.

Vetëm në vitin 2021 ruajtja e gazit natyror në vendburime të tilla në të gjithë Europën, përfshirë edhe Rusinë, ishte 171 *bcm*. Nga këto, 73 *bcm* ishin vetëm në Rusi, kurse pjesa tjetër ishte në të gjithë territorin e Europës. Ne mund të themi se ky studim i fizibilitetit, që ka dalë tashmë, do të na japë ne të drejtën të bëhemi një vend, që krahas kryqëzimit të tubacioneve të TAP-it, IAP-it, zgjerimit të TAP-it, ardhjes së ExxonMobil, ardhjes së firmës nga më të mëdhatë në botë, nëpërmjet kompanisë Excelebrate, që të arrijmë të depozitojmë në Dumre sasi të tilla gazi. Mund të them një shifër afërsisht: me 500 milionë dollarë investime që mund të bëhen, ne bëhemi të barabartë me atë që ka rezervuar Ukraina për vitin 2021, 23 *bcm*.

Kjo do të thotë se politika e qeverisë, në bashkëpunim me ne dhe Kuvendin, duhet të jetë e tillë që të orientohet drejt depozitimit të gazit. Shumë shpejt do të ndryshojë edhe direktiva. Siç është kapaciteti i rezervave të naftës, që duhet të jenë për 3 muaj, do të dalin edhe rezervat e gazit, që do të jetë 9% në të gjithë Europën. Pikërisht, depozitimi në kripëra është mrekullia më e madhe që vetëm ne e kemi në të gjithë rajonin tonë.

Faleminderit!

Petrit Ahmeti - Po vazhdoj përsëri unë, sepse i ndamë pyetjet për arsye të profilit.

Për sa i përket pyetjes për pikat e karikimit të baterive të makinave që janë në përdorim, natyrisht ne kemi marrëdhënie goxha pozitive me bashkitë, të cilat natyrisht administrojnë pikat e karikimit të baterive të makinave.

Për sa i përket pyetjes për HEC-et që janë ndaluar, pjesa e HEC-eve të ndaluar lidhet me dhënien e licencave dhe të drejtave apo me funksionimin e tyre normal. Ndërsa të gjitha licencat dhe të drejtat që janë dhënë për ndërtimin e hidrocentraleve, në dijeninë tonë të

deritanishme, ato janë në funksionim. Natyrisht, ato varen edhe nga kushtet atmosferike në lidhje me prurjet e ujërave, sepse janë ndërtuar në lumenj dhe përrenj të ndryshëm.

Për sa u përket elementeve fotovoltaike, Shqipëria është një nga vendet më të favorizuara në lidhje me këtë problematikë, duke pasur një pasuri të madhe natyrore dhe duke qenë një vend që, nga 365 ditë të vitit, 300 ditë i ka me diell, ne kemi insistuar për të promovuar dhe për të zhvilluar edhe më tej procesin e përdorimit të energjisë diellore për prodhimin e energjisë elektrike. Në dijeninë tonë, një pjesë e madhe e licencave janë dhënë për centrale deri në 2 megavat, të cilat kanë të drejtë ta shesin energjinë elektrike te OSSHE-ja me çmime që vendosen nga Enti Rregullator. Përveç kësaj, janë në proces edhe disa leje me kapacitete mbi 2 mega, të cilat praktikisht do të dalin në treg të lirë dhe do të furnizojnë konsumatorët mbi bazën e çmimeve të tregut, por zhvillimi i këtij prodhimi të energjisë elektrike, të cilin unë do ta ndaj edhe me sistemin e prodhimit nga energjia e erës, është një favor për vendin tonë.

Edhe nga testimet ose nga të dhënat që ne kemi, Shqipëria është një vend me një kapacitet shumë të madh, qoftë për energjinë diellore, qoftë për energjinë e erës, të cilat duhen shfrytëzuar. Në përgjithësi, në të gjithë aktivitetin tonë, ne e kemi mbështetur ose e kemi inkurajuar zhvillimin e këtij sektori, sepse është një nga sektorët që ka një prioritet dhe një të ardhme të sigurt. Kuptohet, energjia diellore dhe energjia e erës janë burime mjaft të mira dhe mjaft të sigurta për prodhimin e energjisë elektrike, sepse lënda e parë janë era dhe dielli, të cilat dihet se çfarë rëndësie dhe vijueshmërie kanë.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Fjala për zotin Mziu.

Xhelal Mziu - Po, zoti kryetar.

Në fakt, duhet të kishim përpara një buletin dhe nuk e kuptoj pse ka dalë me kosto të pambuluar hartimi i një buletini, të paktën për ta sjellë në komisionet parlamentare.

Së dyti, me aq mundësi që pata për të lexuar, shikoj se më shumë është folur apriori, siç foli zotëria edhe tani, duke dhënë disa leksione në lidhje me energjinë diellore apo atë të erës dhe nuk tha se çfarë hapash konkretë po ndërmerren në atë drejtim. Kështu që, do të ishte më normale të kishim pasur një material në formën e një raporti vjetor konkret, për të parë se cilat ishin qëndrimet dhe për hapat që ka ndjekur OSHE-ja, OST-ja apo edhe KESH-i.

Së treti, nuk e di se pse nuk shihet liberalizmi i tregut, sepse zotëria sapo tha që kemi potenciale të jashtëzakonshme jo vetëm hidrike, por edhe në drejtimet e tjera, por tregu i energjisë vazhdon të jetë monopol. Cili është qëndrimi juaj në këtë drejtim? Kemi monopol, sepse flitet që janë 50 deri në 300 HEC-e të vegjël, të cilëve për shkak të burokracisë së

ministrisë apo institucioneve të tjera, nuk po u jepet zgjidhje për investimin e tyre. Cili është qëndrimi juaj?

Gjithashtu, në lidhje me parqet fotovoltaike ka një kufizim, sepse jepen leje vetëm për ata që prodhojnë 2 mega, madje edhe ato kanë qenë monopol, sepse vetëm një numër i kufizuar lejesh janë dhënë para disa vitesh dhe vetëm për 2 mega, në një kohë që po të shikojmë potencialin, kudo në Shqipëri mundet të prodhohet energjie edhe për nevoja vetjake, edhe për nevoja të biznesit. Edhe në këtë drejtim ka kufizime, ka burokraci dhe jo vetëm aq, por ka kompani të cilat prodhojnë energji më shumë se kapaciteti i tyre dhe ju thuhet të bëjnë thjesht një rakordim mujor. Pra, dikush që mund të prodhojë energji, po marr një shifër, 100 ai konsumon 50 dhe 50 të tjera i fal, gjë që nuk e stimulon biznesin për të prodhuar me kapacitete maksimale. A është normale kjo gjë për ju, kur ne blejmë energji me 390 euro apo me 500 euro, ndërkohë që këto biznese e kanë kapacitetin për të prodhuar energji? Pra, cili është qëndrimi juaj? Pse nuk reagoni ju në këtë drejtim?

Tjetër problem. Në informacionet që kemi nuk pashë sesa është numri i të punësuarve në këtë sektor, në këto 3 drejtori, sidomos në OSHE. Sa është numri i punonjësve për 1000 abonentë? Sa është fondi i pagave për vitin 2022 në raport me 3, 5 apo 8 vjet më parë? Sa ka qenë efienca e tyre?

Gjithashtu, nuk kemi një informacion të saktë sesa është numri i kredive dhe vlera e kredisë së marrë nga këto institucione.

Një pyetje tjetër: pse nuk është bërë funksionale bursa që prej vitit 2015? Se ka qenë premtim, madje ka qenë edhe baza ligjore për t'u bërë efektive që në vitin 2015. Pse nuk është bërë? Unë druaj se nuk është bërë qëllimisht, për të anashkaluar bursën në blerje dhe në shitje. Nuk e di se cili është qëndrimi juaj, por kjo punë është zvarritur kaq vjet, saqë është lënë për vitin 2023, por jam i sigurt që edhe në 6 mujorin e dytë të vitit 2023 do të gjendet një artificë për ta shtyrë edhe më tej atë.

Nga informacioni që kam, di se këto ditë do të zhvillohet një tender për blerjen e matësave për çdo kabinë elektrike në Shqipëri. Cili është qëndrimi juaj për këtë? Jam i sigurt që po të azhurnoheni me informacion do ta shikoni edhe fondin e parashikuar, edhe blerjen e këtyre matësave. Dua të di qëndrimin tuaj për këtë gjë.

Në lidhje me humbjen e energjisë eklektike, ka një kontraditë në material, sepse në një vend thuhet që është 21,3 % pastaj diku 81,8%. Nuk po e marrim vesh sesa është realisht humbja e energjisë eklektike.

Në lidhje me debinë, sidomos të institucioneve buxhetore, jo vetëm që ka një debi të jashtëzakonshme, por ne madje sa kaluam edhe raportin e ERRU-së, ku shqetësimi kryesor i

ujësjellësve ishte rritja ose liberalizmi i çmimit të energjisë elektrike. Pra, operatorët prodhojnë dhe shesin energji me 65 euro. Ndërkohë, që ju keni bërë liberalizim, po të shikojmë vetëm Durrësin dhe disa qytete të tjera, arritën të shpenzojnë 3 herë më shumë energji elektrike për shkak të liberalizmit që u keni bërë, kështu që duke mos qenë me çmim kostoje, prodhimi i energjisë elektrike do të japë efekte të drejtpërdrejta te qytetarët në rritjen e tarifës së ujit.

Këto ishin disa nga pyetjet dhe paqartësitë e mia në lidhje me atë që ju keni paraqitur.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Mziu!

Fjala për ju zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti - Faleminderit, zoti Mziu për pyetjet, sepse na jepni mundësinë të sqarojmë një pjesë të problematikave që hasim në tregun e energjisë elektrik, por edhe të gazit natyror në vazhdim!

Po e filloj nga pozicioni i Entit Rregullator në lidhje me pikat e reja të prodhimit të energjisë elektrike. Duke shfrytëzuar të gjitha burimet natyrore, ne jemi një institucion që licencojmë kompanitë pasi ato marrin të drejtën për investimin në këto objekte që prodhojnë energji eklektikë, qoftë nga era apo edhe nga burimet ujore. Natyrisht, ne e kemi përgatitur bazën ligjore për të mos penguar licencimin, procesin e zhvillimit dhe të ndërtimit të këtyre objekteve.

Në lidhje me numrin e punonjësve, ky është një proces që ka ndodhur ndër vite në kompanitë e sistemit energjetik, nuk është se ka ndodhur në vitin e fundit, por me të drejtë unë bashkohem me shqetësimin tuaj në lidhje me eficiencën dhe me numrin e fuqisë punëtore në këto kompani. Natyrisht ne kemi mundësi ta bëjmë analizën e numrit të fuqisë punëtore për këto kompani, por jo në mënyrë të plotë, për të cilat kemi dhënë edhe mendimet tona nëpërmjet vendimeve që marrim, apo kur diskutojmë dhe vendosim për problemet e investimeve që kryen në këto kompani. Këto mendime dhe vendime janë pjesë përbërëse e kësaj analize dhe eficiencës që kanë këto kompani në lidhje me fuqinë punëtore që ato përdorin.

Duhet të kemi parasysh një gjë, Enti Rregullator, pa dashur t'i shmangem edhe pozicionit që ju me të drejtë e kërkon, ka një element të kufizuar për trajtimin dhe menaxhimin e këtij treguesi. Natyrisht, kemi dhënë rekomandime të ndryshme gjatë analizave të çmimeve dhe të kostove që lidhen praktikisht me ato çfarë kërkohen nga kompanitë, por në përgjithësi i kemi qëndruar një përlllogaritjeje duke u bazuar në të dhënat që kanë vetë kompanitë.

Për problemin e bursës së energjisë elektrike, dua të them se dëgjoj shpesh të flitet dhe të diskutohet për të, madje deri te diskutimet, propozimet dhe anatemit, por në një farë mënyre zhvillimi i bursës nuk është një proces që ndodh brenda një viti apo brenda një periudhe shumë të shkurtër. Pa dashur të lehtësoj pozicionin e Shqipërisë, dua të them se të gjitha vendet e rajonit nuk kanë shkuar më tepër se në 2% apo 3 % në trajtimin në bursë të energjisë elektrike. Por ndërkohë dua të them se janë bërë hapa shumë të rëndësishëm tashmë në sistemin elektroenergetik shqiptar për aplikimin dhe funksionimin e bursës. Në emër të Entit Rregullator, unë, ju shpreh sigurinë praktikisht që ky fenomen do të fillojë të jetë funksional menjëherë brenda këtij viti, me funksionimin e bursës së energjisë elektrike, e cila do të çojë më tepër në transparencën e tregut të energjisë.

Unë bashkohem me shqetësimin dhe skepticizmin tuaj, sepse keni të drejtë, por kam detyrimin t'ju shpreh bindjen se këtë vit bursa e energjisë elektrike, mbi bazën e marrëveshjeve që ne kemi bërë deri tani, do të jetë funksionale deri në fund të vitit. Gjithsesi, shpresoj që ne të jemi përsëri këtu në këtë komision të nderuar, ku të jemi edhe dëshmitarë të realizmit apo jo të këtij treguesi.

Në lidhje me blerjen e matësave të energjisë elektrike, nuk kemi një informacion të kësaj natyre, qoftë zyrtarisht apo qoftë në rrugë të tjera, për të dhënë një shpjegim.

(Deputeti Xhelal Mziu flet pa mikrofon nga salla.)

Jo, nuk është marrë asnjë vendim i tillë që energjia të jetë falas.

(Deputeti Xhelal Mziu vazhdon të flas pa mikrofon nga salla.)

Kjo është një eksperiencë dhe unë, ju, falënderoj që e ngrini si problematikë, sepse lidhet pak më gjerë me instalimin e impianteve të energjisë diellore në të gjithë ...

(Deputeti Xhelal Mziu vazhdon të flas pa mikrofon nga salla.)

Ta them unë argumentin tonë.

Domethënë, ka një element në këtë drejtim, prandaj ju thashë që keni të drejtë, sepse ka shumë raste dhe po diskutohet kjo gjë, madje në dijeninë tonë është ngritur një komision nga Ministria e Energjisë në lidhje me kapacitetet prodhues të lejuara për energjinë e erës dhe për energjitë e tjera të rinovueshme. Për energjinë diellore është mundësia që një pjesë e madhe e konsumatorëve industriale, sipërfaqet e tyre mund t'i mbulojnë duke montuar panele fotovoltaike. Ideja është që të bëhet një balancim i energjisë elektrike të prodhuar, që, në qoftë se ata që nuk e konsumojnë energjinë brenda aktivitetit të tyre, ta hedhin në rrjet dhe natyrisht të bëhet një kompensim, por jo mujor, se është një periudhë shumë e shkurtër kohore.

Zakonisht eksperiencia e vendeve të zhvilluara, ne e kemi parë edhe në Itali, që kompensimi për këtë energji bëhet 6-mujor ose edhe vjetor. Pra, kjo është një nga gjërat me të cilën ne aktualisht po punojmë dhe do të vendoset mbi baza të përcaktuara ligjore. Vetëm kini parasysh një gjë, në lidhje me sistemin energjetik, po diskutohet fakti që kapacitet e prodhimi të energjisë elektrike diellore nga përdorimi vetjak në përdorimet që shkojnë mbi 30 mega, do të futen në treg të rregulluara. Kjo gjë ka nevojë edhe për dispeçerim, kështu që ne jemi duke diskutuar për ndërtimin dhe hartimin e rregullave të dispeçerimit.

Ju kërkohet ndjesë nëse lashë ndonjë pyetje pa u përgjigjur.

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Nasufi.

Pastaj e kanë fjalën zoti Gështenja dhe zoti Avdulla.

Fadil Nasufi – Në këndvështrimin tim raporti është shumë analitik dhe sintetizues për të gjithë rolin dhe funksionin që kryen Enti Rregullator. Pa dyshim, që na informon, por është dhe reflektues edhe ndaj rekomandimeve të Kuvendit, në çdo raport vjetor që bëhet, në fakt, por edhe reflektues ndaj një situatë të cilën ne e përballojmë me kostot që ka për shkak të krizës botërore që është është edhe në fushën e energjisë.

Mua më vjen mirë që këtu kemi drejtuesin e ERE-s, jo vetëm në cilësinë e Kryetarit të Bordit, por edhe të Presidentit Drejtues të MEDREG-ut për 25 vende të Mesdheut, i cili na sjell j vetëm një përvojë tipike shqiptare, por edhe një përvojë të të gjithë rajonit. Gjithashtu, kemi edhe zotin Shuli që është njëri nga ekspertët, dhe jo thjesht një anëtar bordi, nga më të mirët në fushën e energjisë dhe të gazit. Kështu që, duke qenë nën negativizmin e krizës dhe të problematikave që dalin, ne nuk duhet të kursejmë as fjalët pozitive dhe as mbështetjen për Entin Rregullator të Energjisë, si duhet të fokusohemi në raportin vjetor. Raport vjetor për vitin 2021, quhet i tillë pasi ka pambushur 5 rekomandimet e Kuvendit dhe ka në proces 8 rekomandime të tjera, të cilat vlerësohen pozitivisht në zbatimin e detyrave për të cilat ata janë këtu, në rolin e rregullatorit dhe të mbikëqyrësit të funksionimit të tregut të energjisë, të ruajtjes interesit të konsumatorit dhe reflektimit ndaj gjithçkaje që ndodh në tregun e energjisë.

Hapa pozitivë janë shënuar edhe për bursën, edhe për çështjen e bashkimit të tregut me Kosovën dhe kështu me radhë. Këto janë sinjale, por ne kërkohet një gjuhë praktike, me më shumë shembuj të shkëputjes nga varësia hidrike e energjisë dhe e futjes së energjisë alternative. Rasti më ka sjellë të njoh shumë sipërmarrës që interesohen të marrin licenca në fushën e investimeve fotovoltaike, ndoshta nga Ministria e Infrastrukturës apo nga institucione të tjera pengohen, por që kanë vullnet, të cilëve duhet t'u përshpejtohet shansi që

të futen në mundësitë e investime, që t'i shërbejnë edhe interesit të tyre për këtë lloj biznesi, por t'i shërbejnë edhe tregut dhe përmirësimit të furnizimit me energji elektrike nga burimet e brendshme që ka Shqipëria. Shumë pyetje që bënë kolegët morën përgjigje. Unë kam vetëm një pyetje në lidhje me gazin. Kam lexuar shkrime apo ka aludime dhe paragjykime rreth komenteve që gazsjellësi që kalon në Shqipëri është vetëm tranzit dhe pengon gazifikimin e Shqipërisë. Ka pasur një shkrim të Bashkim Bahollit shumë të gjerë në lidhje me kontratën sesi është menaxhuar dhe sesi është anashkaluar. A e kemi në mundësinë si pozicion gjeografik që jo vetëm të kthehem në një faktor, duke gazifikimin e vendit, por edhe duke qenë një nyje rajonale për shkak të këtij potenciali, që e shpjegoi edhe zoti Shuli në sqarimin e pyetjes që bëri zoti Zeqaj?

Në pikëpamjen e ndryshimeve ligjore: çfarë ndryshimesh ligjore kërkoni të sillni në Parlament, që ne t'i votojmë dhe t'i vëmë në dispozicion?

Në lidhje me gjyqet: cilat janë proceset kryesore të gjyqeve që kanë hapur subjekte apo familjarë të ndryshëm në lidhje me ERE-n?

Problematikat e faturimeve aforfe, janë më shumë penalitete që rëndojnë te konsumatori apo janë detyrime që i takojnë operatorit të shpërndarjes? Pra, a vazhdon rituali i ndëshkimit të padrejtë dhe ku gjithmonë kostoja është te konsumatori?

Këto pyetje kisha, pak a shumë, si më specifike, sepse për bursën edhe për aspekte të tjera që pyetën kolegët mora përgjigje

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Nasufi!

Zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti – Faleminderit!

Po e nis nga pika e fundit. Aktualisht faturime aforfe nuk ka më në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes. Ne i kemi fshirë prej vitesh këtë fenomen. Nëse rastet janë të tillë që ka një dëmtim matësi apo fenomen tjetër, ka një kohë të limituar që OSHEE-ja është e detyruar ta zëvendësojë menjëherë matësin dhe jo më shumë se dy ose tri muaj mund të faturojë aforfetë, duke pasur një sasi referencë të të njëjtit muaj të vitit të kaluar, në mënyrë që të jemi sa më korrektë edhe me konsumatorët familjarë.

Për sa u përket procese gjyqësore që ne kemi, mund t'ju them se janë shumë të limituara aktualisht dhe lidhen me ankesat e konsumatorëve. Këto janë elemente, të cilët janë lehtësisht të verifikueshme dhe ka një rënie drastike lidhur me ankesat e proceset gjyqësore, që ne kemi marrë pjesë për të zgjidhur mosmarrëveshjet midis klientëve dhe kompanisë së OSHEE-së për problemin e faturimeve, mbifaturimeve e të tjera me radhë.

Në lidhje me problemin e klasifikimin të mëtejshëm të pozicionit të Shqipërisë, natyrisht, pozicionin gjeografik në të gjithë e njohim dhe dimë njëën për zhvillimin e sektorit dhe interkonjeksionit të sistemeve të gazit.

Zoti Shuli mund të shpjegojë më tepër lidhur me problemin e zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të infrastrukturës së gazit natyror në Shqipëri.

Maksim Shuli- Faleminderit për pyetjen!

Faktikisht, më vjen mirë që u bë një pyetje e tillë, sepse dua ta sqaroj në mënyrë shteruese këtë të vërtetë. Projekti TAP ka qenë përballë Nabucco dhe është një fat i madh që është projekti TAP ishte me 20 bcm dhe Nabucco ishte me 50 bcm dhe fitoi TAP-i me mbështetjen e SHBA-ve. Ky ishte një projekt, i cili u kërkua nga projektuesit e asaj kohe që të bëheshin disa lëshime të vogla dhe të bëhej diversifikimi i burimeve të energjisë dhe të gazit. Në qoftë për vitin 2021 nga Rusia erdhën 150 bcm, 53 i mori Gjermania, 36 Turqia, 29 Italia, 2,8 Greqia dhe 0,3 Maqedonia dhe pjesën tjetër Europa, Bullgari deri në Austri. Kjo do të thotë që ky projekt ka qenë realisht i vërtetë dhe është një fat për ne që nuk kishim një tubacion të tillë, një projekt gjigand që kaloi sot. Sot ai tubacion do të jetë një e rëndësishme.

Më 1 mars të vitit 2013 është marrë një vendim unison nga ERE e Shqipërisë, ERE e Italisë, si dhe nga ERE e Greqisë, sepse është kërkuar nga ata që iniciuan projektin TAP që të kalonte dhe të bëheshin disa përjashtime, në bazë të nenit 36 të direktivës së gazit, të cilat do t'i them shumë shkurt. Është bërë një analizë e riskut se çfarë humbet dhe çfarë fitojmë, në këtë analizë ka marrë pjesë edhe EMRA, që është kompania më e madhe turke, e cila rreth 55 bcm që e menaxhon, ka marrë pjesë ACER-i, Shoqata Rregullatorë e Energjisë për Europën, është konsultuar disa herë me DG Energy, Drejtorinë e Përgjithshme të Energjisë në Bashkimin European, me Drejtorinë e Përgjithshme të konkurrencës në BE, pra, janë bërë një mori takimesh dhe, në fund fare, është marrë vendimi që në 14 maj 2013 sekretariati i Komitetit i Energjisë, meqenëse ne jemi shtet kandidat, nuk ishim anëtar, ka dhënë opinionin e tij që është konform këtyre lëshimeve, sepse janë më shumë fitime sesa humbje dhe, me datën 16 maj Komisioni European miratoi me vendim të posaçëm pikërisht këto lëshime. Cilat janë lëshimet?! Lëshimet janë për kapacitetin 10 miliardë, të cilat janë referenca fare minimale, 0,3 eur0 për 100 kilometra, domethënë, 3 milionë euro. Vetëm investimi që ka bërë TAP-i në Shqipëri është një vlerë kolosale. Vetëm të drejtën që kemi marrë ne nga këto lëshime, pra, që të jetë 3bcm-2bcm në vit, pra 2 miliardë metër kub gaz, kur ne kemi konsumuar vetëm 1,2 miliardë metër kub gaz. Ne kemi të drejtën që të zgjerojmë pikat ku ka nevojë Shqipëria. Në kohën e market testit ne kemi kërkesë për në Roskovec që të ndërtohet

një TEC me 0,3 bcm, kemi kërkesë për në Korçë dhe në Fier. Kërkesa për këtë market test shkon deri në 3bcm. Këtë market test, i cili përfundon në tetor, 3 entet e tjera rregullatorë të energjisë e quajnë market testi për Shqipërinë. dua t'ju sqaroj që ky projekt gjigand na bën neve të jemi një hap, sepse me rritjen e kapacitetit nga 10-20, me ardhjen e Excelerate Energy, ExxonMobil, të cilët do të ndërtojmë terminalin, ai do të jetë minimumi 10 bcm, me zhvillimin e vendburimit të naftës dhe të gazit, që është në Shpirag, i cili ka 100 000 metër kub gaz një pus dhe 200 tonë naftë, që do të thotë janë rreth 300 tonë naftë në 24 orë, që nuk janë pak. Ne kemi pjesën tonë 25 me 75, sepse ata kanë investuar, por është një burim që ne të futemi në tubacionin e gazit. Pra, edhe Excelerate Energy, ka kërkuar që në Fier të marrin dy pika hyrjeje me idenë që të ndërtohet tubacioni i IAP-it, ku pjesa jonë është 156 milionë euro, dhe të shkojë deri në Kroaci. Terminali kroat, terminali grek dhe terminali që do të ndërtohet nga Excelerate Energy do ta bëjnë këtë vend që rreth 40 bcm në vit, pra, nëse Ukraina ka 23 BCM në vit, ne mund ta kemi më shumë.

Unë mund të flas edhe më shumë për këtë, por po e mbyll duke thënë se ky projekt na zhvillon të gjitha drejtimet.

Arben Pëllumbi- Ju falënderoj!

Zoti Gështenja, fjala për ju.

Lefter Gështenja- Faleminderit, kryetar!

Dua të them, ashtu siç e tha edhe kolegu im, zoti Bushati, të ftuarit të mos na flasin shumë për të ardhmen, por për atë që është realizuar, sepse është raporti vjetor i vitit 2021, sepse mund të zgjatemi pa fund.

Gjithsesi, respekt dhe konsideratë për orientimin që bëri zoti Ahmeti, kryetari i bordit drejtues të ERE-s.

Unë do të jem konciz në fjalën time. Në atë që pashë në raport nuk del e qartë se sa është borxhi që kanë KESH sh.a, OSHEE-ja dhe OST sh.a?

Së dyti, dua të di si ka mundësi që është marrë një vendim në muajin prill për faturimin e biznesit me një tarifë 19,6 lekë, ndërkohë që nga muaji janar kjo do të ketë fuqi prapavepruese, edhe pse ky vendim nuk është botuar në Fletoren Zyrtare, apo i publikuar në faqen zyrtare të ERE-s?

Lidhur me rekomandimet e Kuvendit për ndryshimin e sistemit të faturimit nëpërmjet implementimit të matësve inteligjentë të energjisë. Institucioni që ju drejtoni, ERE, a ka një analizë reale kostoje përfitimi të këtij projekti dhe sa do të jetë fatura financiare për këtë projekt? Nëse ky projekt do të implementohet, cila është arsyeja që vazhdohet me instalimin

e matësve tradicionalë, a nuk do të jetë ky në të ardhmen një dëm ekonomik për institucionin tuaj apo për institucionet e tjera?

Në raport pranohet se TEC Vlora ndodhet në kushte të konservimit, ndërkohë, qoftë në medie, por edhe nga drejtuesit e qeverisë, është pranuar që do të merret me qira një impiant lundruar në Vlorë. A ka një analizë kostoje përfitimi, ndërkohë, ne e dimë që çmimi i karburantit sot është rritur? Sa është kostoja ditore?

Cila është arsyeja që sot OSHEE-ja nuk prokuron energji, mos ndoshta kjo lidhet me arsyen që nuk ka fuqi paguese?

Lidhur me listën e operatorëve të publikuar në raportin e ERE-s për vitin 2021. Nuk këtë raport nuk del si prodhues energjie impianti i inceneratorëve të Elbasanit, ndërkohë që pretendohet se ky impiant ka prodhuar dhe shitur energji. Pyetja ime është: me çfarë çmimi është shitur energjia dhe kujt ia ka shitur këtë energji?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi- Faleminderit, zoti Gështenja!

Fjala për ju, zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti- Ju kërkohet ndjesë!

Po e nis me pyetjen e fundit lidhur me pyetjen e fundit në lidhje me inceneratorin. Inceneratorin ne e kemi licencuar, sipas kërkesës, që në momentin e parë të fillimit të funksionimit të tij për një periudhë të caktuar kohore, e cila tani ka mbaruar, dhe ne kemi filluar përsëri, mbi mazën e një kërkesë, por jo të të njëjtit subjekt, për fillimin e licencimit të këtij objekti. Aty është prodhuar energji elektrike dhe ka një balancë midis prodhimit të energjisë elektrike dhe konsumit që ata kanë bërë. Natyrisht, këtu do të bëhet një kompensim i energjisë, sepse ne nuk do të ndërhyjmë të përcaktojmë çmimin e energjisë që është prodhuar deri tani, duke menduar se do të ishte më...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do ta shpjegoj deri në fund.

Domethënë, inceneratori i Elbasanit ka prodhuar energji elektrike në funksion të aktivitetit të tij, duke bërë djegien e mbeturinave dhe të tjera me radhë. Pra, ka prodhuar një sasi energji elektrike. Kjo sasi energjie elektrike që normalisht duhej t'i jepej OSHE-së, nuk ka pasur një çmim, sepse inceneratorit i Elbasanit në fuqinë e tij ka një fuqi më të madhe nga ajo që është përcaktuar në ligj, për të vendosur një çmim nga ana e Entit Rregullator. Atëherë, duke qenë se ishte në funksion të një strukture jo shtetërore dhe nuk kishte një kontratë ose një marrëveshje me pushtetin lokal të Elbasanit, kjo energji që është prodhuar, praktikisht nuk është paguar ajo që është hedhur në rrjet. Në fazën e parë ideja është që të ketë një

kompensim vetëm mall me mall, energji elektrike me energji elektrike, ndërsa tani, që është marrë nën administrimin e Bashkisë së Elbasanit, ku janë dy struktura shtetërore, ne kemi filluar një proces, por në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Energjetikës, për të përcaktuar një çmim mbi bazën e kostos dhe mbi bazën e të gjithë të dhënave që inceneratorit i Elbasanit do të paraqesë pranë Entit Rregullator. Përtej fakti që jemi edhe në një proces gjyqësor, sepse ne na është kërkuar vendosja e çmimit të energjisë eklektikë, por duke qenë jashtë kompetencave të Entit Rregullator ne kemi mbajtur qëndrimin tonë. Jemi në një proces gjyqësor dhe normalisht po presim që ky proces të përfundojë. Faza e parë ka përfunduar duke i dhënë të drejtë strukturës administrative të inceneratorit, ndërkohë ne presim të përfundojë ehe faza e dytë. Ndërkohë, duke qenë se ka një diferencë nga fillimi i procesit me situatën që është tani, pasi tani është një objekt nën administrimin e bashkisë së Elbasanit. Pra, kemi të bëjmë me një strukturë shtetërore, dhe është më e lehtë të merret një vendim në lidhje me çmimin e energjisë elektrike. Ne jemi duke e analizuar dhe kemi hapur një korrespondencë me përfaqësuesit e tyre duke u marrë të dhënat në mënyrë që të fillojmë edhe një trajtim të analizës që mund të bëjmë për çmimin e energjisë elektrike.

Arben Pëllumbi – Ka një ndërhyrje zoti Gështenja, në mënyrë që ta bëjmë edhe interaktive mbledhjen.

Lefter Gështenja – Kërkoj ndjesë që ndërhyj, por më duhet të ndërhyj, që t'ju informoj dhe të sqaroj që në kontratën, qoftë për inceneratorin e Elbasanit, qoftë edhe për dy inceneratorët e tjerë, siç janë Tirana dhe Fieri, parashikohet qartë që kompanitë e inceneratorëve duhet t'i paguajnë një *fi* shtetit për energjinë që prodhojnë. Ndërkohë, nuk mund të vazhdojmë të themi që nuk ka pasur çmim dhe nuk do të ketë çmim, sepse është e parashikuar në kontratë dhe ju si institucion duhet ta keni kontratën dhe duhet të jeni në dijeni të kësaj kontrate që ka lidhur shteti qeveria me kompaninë e inceneratorëve. Inceneratori i Elbasanit duhet të kishte 5 vjet që prodhonte energji dhe t'ia shiste shtetit me një tarifë të përcaktuar nga shteti mbi bazën e së cilës buxheti i shtetit duhet të përfitonte *fi*-në koncesionare. E njëjta gjë duhet të ishte edhe për Fierin, për të cilin nuk po e hap sot në këtë bisedë, i cili duhet të kishte më shumë se 4 vjet prodhim. E njëjta gjë duhet të ishte edhe për inceneratorin e Tiranës, ku janë 3 faza, linja e parë duhet të ishte në prodhim prej 2 vjetësh. Pra, në asnjërin prej inceneratorëve, kur janë ngritur, qëllimi nuk ka qenë thjesht djegia e mbeturinave, por ka qenë edhe prodhimi i energjisë, gjë që sot duhet pranuar publikisht, të paktën edhe nga ju, që këto inceneratorë nuk kanë prodhuar asnjë lek energji elektrike edhe pse kanë gllabëruar një pjesë të mirë të buxhetit të shtetit. Këtë ne duhet ta pranojmë, pra shteti ka përfituar zero lekë lidhur me këtë.

Arben Pëllumbi – Zoti Gështenja, të mos i kthemi kësaj teme. E kemi diskutuar 100 herë.

Lefter Gështenja – Jo, të lutem...

Arben Pëllumbi - ...që ka prodhuar, dihet që ka prodhuar.

Lefter Gështenja – Jo, të lutem, më lejo ta mbaroj bisedën!

Unë besoj që ju duhet të jeni në dijeni të të tre kontratave të inceneratorëve dhe nuk mund të themi që nuk do të ketë çmim, do të balancohet, do të ketë një marrëveshje mes pushtetit vendor. Jo, sepse nëse nuk ka çmim, nuk ka vlerë, buxheti i shtetit nuk fiton gjë nga kontrata.

Nëse nuk bie dakord ma thuaj.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Po, urdhëroni!

Petrit Ahmeti – Nuk është fakti se nuk biem dakord, unë po flas për pozicionin e ERE-së në lidhje me këtë proces. Ky proces, mund ta them me garanci të plotë, se i kemi bërë edhe matjet, në atë incenerator është prodhuar energji elektrike, është hedhur në rrjet dhe kjo dihet, sepse ka një balancë. Në një moment të caktuar ata përdorin energji elektrike, e marrin nga rrjeti dhe, mbi bazën e prodhimit dhe aktivitetit të tyre e hedhin energjinë elektrike në sistem.

Unë nuk dua të futem në detaje në këtë element, sepse ERE-ja ka një distancë nga i gjithë procesi që po kryhet dhe po diskutojnë, por dihet që inceneratori konsumon dhe prodhon energji, të cilin e hedh në rrjet se nuk ka ku ta çojë tjetër. Akumulimi është akoma një proces i pazhvilluar i këtyre prodhimeve. Ka një fenomen që hedhja e energjisë në rrjet ose mund të bëhet me një kompensim me energjinë e marrë deri tani dhe energjinë që kanë hedhur në rrjet, ose mund të zerohet. Ndërsa nga ky moment ,në lidhje me administrimin që ka kaluar në Bashkinë e Elbasanit, ku kemi të bëjmë me një objekt shtetëror me një strukturë shtetërore, ne kemi filluar një proces analize për përcaktimin e një çmimi, me të cilin mund të shitet kjo energji.

Për të gjitha fenomenet e tjera do t'ju lutesha ta mbanit në distancë ERE-në, sepse nuk ka ndonjë problem lidhur me procesin, por dua të jem shumë i sqartë dhe transparent për pozicionin që ka ERE-ja me inceneratorin. Siç kërkoni mirëkuptimin tim ,ashtu dhe unë kërkoi mirëkuptimin tuaj në këtë drejtim.

Në lidhje me impiantet lundruese, kjo është një nga mënyrat e prodhimit të energjisë elektrike, që njihet në botë, nuk është hera e parë që ndodh. Natyrisht lidhet me termocentralin e Vlorës dhe fatkeqësisht ka shumë kohë që ka kaluar në amortizim fizik dhe

moral, siç quhet ne gjuhën teknike. Arsyeja pse nuk është vënë në punë termocentrali i Vlorës dihet, sepse në atë kohë lënda e parë ka qenë me çmime shumë të larta dhe kostoja e prodhimit të energjisë elektrike natyrisht që do të ishte shumë e lartë dhe nuk ishte e përshtatshme për tregun në të cilin gjendej energji elektrike, pra me çmime me të ulëta krahasuar me koston e prodhimit të këtij termocentrali.

Në kushtet kur ballafaqohemi me çmime relativisht të larta në import dhe në tregun rajonal, natyrisht vendosja në punë e termocentralit bëhet një imperativë dhe është një kapacitet i shtuar në kuptimin termik, jo thjesht për të kompensuar kapacitetin hidrik dhe termik, se kjo ka vlerë për sistemet e mbyllura, por tani që e kemi dhe jemi të ndërlidhur nuk ka problem për gjetjen e energjisë elektrike, por për koston e prodhimit dhe çmimi i saj.

Prodhimi i energjisë elektrike nga dy impiantet që propozohen, natyrisht është një propozim në diskutim, ne jemi ftuar të bëhemi pjesë e këtij diskutimi duke kërkuar, siç kërkon ju pjesën e koston dhe çmimit të energjisë elektrike, po të njëjtën kërkesë dhe po të njëjtin pozicion është nga ne, si institucion, jo thjesht për arsye të pozicionit, përgjegjësisë ligjore dhe detyrës që kemi, por edhe për t'u interesuar për mbrojtjen e konsumatorëve dhe çmimet e tregut të energjisë elektrike që do të jenë.

Kështu që, ka një dualizëm midis kapacitetit të munguar dhe çmimit të produktit të këtyre kapaciteteve, që është energjia elektrike.

Në lidhje me furnizuesin e mundësisë së fundit, të cilin ju e trajtuat, është një problem kryesisht i OSHEE-së, për të cilin ne jemi jo në diskutim, por në monitorim të aktivitetit të OSHEE-së. Pse e përmend furnizuesin e mundësisë së fundit? Pra, pse është vendosur një çmim pasi kanë kaluar muajt janar, shkurt dhe mars, që lidhet pikërisht me pyetjen tuaj që e kemi dëgjuar edhe në media? Çmimi i furnizimit të mundësisë së fundit është një element kompensues dhe kjo duhet kuptuar në metodologjinë e përcaktimit të çmimeve, për të cilin nuk mendoj se është rasti të futemi në detaje. Ndoshta kjo është një arsye e mungesës së komunikimit më të shpeshtë që ne kemi mes nesh, ju si anëtarë të komisionit dhe ne si rregullatorë, sepse ka shumë problematika që duhet t'i sqarojmë dhe unë këtë do ta bëj si vërejtje në fund fare, sepse ne takohemi vetëm në momente të veçanta për të dhënë shpjegimet tona përpara komisionit parlamentar, ndërkohë që si ju, ashtu dhe ne kemi nevojë për këtë bashkëpunim dhe për një komunikim më të shpeshtë. E kam dëgjuar edhe në media këtë pjesën e çmimit të furnizuesit të mundësisë së fundit, por kjo nuk lidhet me një vendim prapaveprues, këtë gjë duhet të kuptojmë.

Nuk e di nëse lashë diçka pa thënë.

Lefter Gështenja – Keni pasur të gjithë mundësinë ta shtrinit përtej janarit, ta çonit edhe për vitin 2021 këtë fashën 19,6 lekë, pse deri në janar? Jeni treguar dashamirës me biznesin, nëse e keni pasur ju në dorë, ose qeveria. Pra, keni marrë një vendim në prill që ky vendim të ketë fuqi prapavepruese, unë nuk i di teknikalitetet se mbi çfarë baze merret vendimi për vendosjen e çmimit, por nuk e quaj normale, nuk është *fair* t’i thuash biznesit që, edhe pse e ke blerë në janar me 18, do ta paguash me 19. Nëse është normale, ka rregulla të qarta, por ta shtrijmë edhe për 2021-n këtë gjë, se jemi keq me buxhetin.

A është normale, a është e rregullt? Unë them jo për sa kohë ky vendim nuk është publikuar as në Fletoren Zyrtare dhe as në *website*-in e ERE-së.

Petrit Ahmeti - Unë nuk dua të zgjatem në veshjen ironike të kësaj që thatë, por nuk është ky problemi që kemi për ta zgjatur deri në fund të vitit, sepse ka disa analiza që kemi nevojë të presim për të ditur si ka qenë pjesa e konsumit për të bërë edhe kompensimin e energjisë elektrike për këta konsumatorë. Unë jua shpjegova, nuk është një vendim që lidhet me përcaktimin e çmimit për një periudhë të mëvonshme, por është kompensimi dhe korigjimi i mënyrës së faturimit për tre muajt e kaluar, fenomen i cili nuk do të zgjasë deri në fund të vitit, për këtë të jeni të sigurt, por ishte i nevojshëm për fazën ku ishim, me ndryshmet dhe me vendimet që u morën nga qeveria dhe çmimet e përcaktuara se sa do të ishte çmimi i biznesit, i cili nuk u ngrit menjëherë dhe nuk u vendos në nivele të larta siç ishte oferta e tregut.

Arben Pëllumbi – Po, zoti Duraj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Gështenja, unë thashë që nuk u është përgjigjur të gjitha pyetjeve tuaja, ju ndërhytë dhe ndërhytë vetëm për këtë çështje dhe zoti Ahmeti pyeti nëse keni diçka tjetër, se ndoshta mund t’i kishte mbetur ndonjë pyetje pa shpjeguar.

(Diskutime pa mikrofon.)

Petrit Ahmeti – Borxhi mes kompanive, natyrisht, është një fenomen i trashëguar, i cili ka filluar që nga procesi i ndarjes së aktiviteteve të sistemit të shpërndarjes, natyrisht nuk ka qenë borxh i vogël, por vit pas viti është ulur. Në lidhje me këtë pyetje, unë kërkuj të drejtën t’i përgjigjem pak më vonë, në mënyrë që të kem shifra më të sakta për t’jua transmetuar.

Ekziston një borxh midis kompanive, por sa vjen e limitohet. E thashë që është një proces jo i thjeshtë, është shumë i vështirë për zerimin e këtyre borxheve mes kompanive.

Arben Pëllumbi – Zoti Duraj.

Laert Duraj – Përshëndetje!

Këtu jemi në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit dhe për mua është një lajm shumë i mirë që rreth 40% e energjisë prodhohet nga sektori privat, siç e përmendët. Kjo tregon për punën e mirë të qeverive shqiptare, pa i dalluar, por edhe tuajin si rregullatorë, sepse keni bërë të mundur që terreni këtu të jetë pozitiv, investimet reale dhe të qenësishme. Megjithatë, dua të flas për një shqetësim që ngriti zoti Mziu, kohët e fundit kemi disa pika takimi, që ka të bëjnë me bizneset. Unë dua më shumë fokus për sa u përket investimeve që vetë bizneset bëjnë për energjinë për nevojat e tyre. Mendoj se është një sektor, i cili ka një potencial jashtëzakonisht të madh, vërtetë janë të vogla në pamje të parë, por panelet diellore dhe jo vetëm, që shërbejnë edhe si një lloj izolimi të ndërtesave, mund të jenë një burim shumë i madh dhe i rëndësishëm për energjinë shqiptare. Pra, janë të gjitha incentivat, sidomos për bankat, që janë të dëshiruara të investojnë dhe të japin kredi për këtë lloj sektori, që të merret shumë në konsideratë. Kështu që, edhe në vazhdimin e asaj që thatë ju, do të doja që kjo gjë të përfshihet në rekomandimet tona, nëse do të ishte e mundur, pra në njëfarë mënyre rregullatori të kishte më shumë përgjegjësi në lidhje me këtë sektor, që ta bënte më efikas, më të lehtë procedurën.

Duke përfutuar nga ajo që shprehët, ndoshta nxitohem, por edhe me vendimin e kolegëve, të linim një bisedë këtu në komision nga muaji qershor vetëm për këtë temë, pa e bërë shumë të komplikuar gjënë, personalisht, por edhe një pjesë e madhe këtu që vijnë nga biznesi e konsiderojmë shumë të rëndësishme këtë qasje. Pra, ndoshta ta lëmë për muajin qershor për të diskutuar konkretisht se çfarë mund të bëhet për biznesin, që t'i bëjmë të dëshiruar të investojnë jo vetëm për të plotësuar nevojat e tyre, por edhe se si pjesa t'u shitet bizneseve që kanë në krahë, ndoshta rritet të OSHEE-së, nuk e di, prandaj ju vlerësoj si rregullator që të gjeni një lloj mundësie, apo një mënyrë se si ta bëjmë më të mirë klimën tuaj në sektor.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Duraj!

Petrit Ahmeti – Unë thjesht doja t'ju falënderoja për ndërhyrjen, sepse vërtetë është një nga kërkesat tona si institucion që nuk duhet të ketë vetëm llogaridhënie përpara komisionit, por unë insistoj edhe në bashkëpunimin institucional që mund të ndërtojmë. Natyrisht, kemi shumë pika që mund të dialogojmë, mund t'i sqarojmë gjërat me njëri-tjetrin jo vetëm se jemi në një pozicion llogaridhënieje, por që të bashkëpunojmë për tematikat dhe problematikat që diskutohen.

Këtë doja të shtoja.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Ahmeti!

Dera e Kuvendit të Shqipërisë dhe në veçanti e këtij komisioni ka qenë gjithmonë e hapur dhe iniciativën nga ana jonë, kur kërkoni mbështetjen e komisioni, do ta gjeni gjithmonë pa diskutim kohën e duhur për të bashkëpunuar me ne në ato tema ku kemi mundësi të ndërhyjmë.

Fjala për zotin Avdulla.

Nusret Avdulla – Faleminderit, zoti kryetar!

E vlerësoj raportin, si dhe sqarimet në lidhje me të.

Kam disa pyetje dhe po tregohem me tepër lokalist. A ka ndonjë studim, apo ndonjë projekt pilot në lidhje me klasifikimin e qarkut të Fierit, meqë ka edhe një eksperiencë të tillë ndër vite, sado e pakët që është?

E dyta, Albpetrol sh.a prodhon një sasi gazi, që quhet gaz shoqërues, profesori e di më mirë, që është përdorur për djegie për shumë biznese ndër vite. Me sa di për momentin po punohet përsëri për ta vënë në punë. Do të ishte shumë e rëndësishme që kjo sasi gazi të vihej në punë, sepse nuk shkakton ndotje mjedisore dhe mund të shërbejë edhe për shumë biznese që kanë punuar ndër vite. Po ju them një detaj: me këtë gaz kanë punuar rreth 50 furra buke, që po të jetë ky gaz menjëherë çmimi shkon prapë ku ishte, se kostoja që zë lënda djegëse në të gjitha furrat e bukës me këto çmime që janë shkon gati 50%. Kështu që, do të doja ndikimin tuaj që të vihej sa më shpejt në punë.

Më lind natyrshëm një pyetje tjetër: e keni shumë më të lehtë marrjen e sasive të gazit nga Amerika, apo nga cisterna, që do të instalohet për të kthyer gazin e lëngshëm në gaz metani, por a i keni ezauruar të gjitha resurset që ka vendi ynë dhe të hidhemi në Amerikën e largët?! Mendoj se, duke e paraqitur gazin si një alternativë karshi energjisë elektrike, është menduar shumë pak, për të mos thënë fare për ta bërë eficiente për të kursyer energjinë elektrike. Di që në qarkun tonë ka disa zona, që kanë qenë goxha me gaz, a ka ndonjë operator që vepron ndër to për momentin dhe cila është perspektiva e tyre?

Këto pyetje kisha dhe do të doja të dija a ka afate për të gjitha ato që foli profesori që t'ia shohim hairin kësaj pune?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Zoti Ahmeti?

Petrit Ahmeti – Faleminderit!

Natyrisht, këto janë pyetje shumë konkrete dhe të qenësishme.

Unë do të flas diçka në lidhje me afatet.

Mua më vjen mirë që jemi shumë ambiciozë dhe agresivë në kërkesat që duhen plotësuar për të zhvilluar të gjitha këto projekte.

Unë gjithmonë e krahasoj sistemin e energjisë elektrike me të cilin furnizohen familjarët. Deri para pak vitesh ne kemi diskutuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve, ndërsa tani diskutojmë për cilësinë e energjisë elektrike me të cilën furnizojmë konsumatorët, sepse praktikisht kemi arritur disa nivele ku kërkojmë cilësi. Në qoftë se deri para disa vitesh këto çështje, që ju me të drejtë i shtruat, nuk diskutoheshin, tani janë bërë imperative dhe i kemi në tavolinë për t'i diskutuar.

Në vazhdim të diskutimit tim, në respekt edhe të profesionit, fjalën po ia lë zotit Shuli, për t'ju dhënë sqarimet e nevojshme.

Maksim Shuli – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen e parë, faktikisht ka një studim për gazifikimin e Shqipërisë, i cili është bërë me mbështetjen e TAP-it, i cili ka investuar për këtë. Janë 6 projekte prioritare, këtu kam parasysh Fierin, Kuçovën deri në Sarandë, njëkohësisht edhe shtrirjen e IAP-it nga vendi ku është stacioni i kompresorëve në Fier, deri në Kroaci.

Do t'ju them me përafërsi një shifër që do të duhet për gazifikimin e të gjithë Shqipërisë dhe që shkon në 4 miliardë, pra nuk është pak. Sa u takon 6 projekteve emergjente, projekti i parë është ai nga Vlora në Fier, i cili është rreth 29 milionë euro, ku projekti i zbatimit është bërë dhe është gati për të filluar. Po ashtu, është bërë edhe projekti i zbatimit për IAP-in nga Fieri deri në kufi me Kroacinë. Ndërkohë, projekti IAP, do ta zhvillojë infrastrukturën e vendit në mënyrë gjatësore dhe çdo qytet i Shqipërisë do të krijojë degë, përfshi edhe Kukësin, i cili do të lidhet Alco Gap-in, siç është Kosova, pra të hiqet edhe ndotja në Kosovë, duke hequr qymyrin dhe përdorur gazin.

Projekti IAP ka të bëjë me Komunitetin European dhe është në përfundim të dhënies së fondeve, ndërsa projekti prej rreth 29 milionësh Fier-Vlorë ka të bëjë me Tec-in e Vlorës, me kompanitë Exceletrate dhe Exxo Mobil, të cilat janë ndër kompanitë më të mëdha.

Pra, në perspektivën e përgjithshme studimi është bërë dhe tani ka ngelur vetëm rakordimi nga ana e qeverisë me firmat private dhe shtetërore, mundësisht të futen edhe kompanitë tona si aksionere, por këto janë politika të qeverisë dhe ne do të bashkëpunojmë me të.

Sa i takon pyetjes së dytë, që kishte të bënte me Alpetrolin, faktikisht, Alpetroli prodhon një sasi gazi shoqëruar, por ai gaz lëviz, pasi në Cakran është deri 8%, ndërsa në Marinzë dhe Patos, të cilat nuk i ka Alpetroli, por të tjerët, prodhohet më pak. Faktikisht Alpetroli, por edhe firma Bankers, të cilën e shfrytëzojnë kinezët, duhet të punojë me sisteme të mbyllura. Sistem i mbyllur do të thotë që aty ku është gryka e pusit duhet të vendosen guarnicione, por këto faktikisht kanë kosto, në mënyrë që të mos dalë gazi në hapësirë.

Faktikisht e gjithë zona është e ndotur, të jemi të ndërgjegjshëm dhe të mos e mohojmë, por e gjithë ajo sasi gazi që mund të mblidhet, rreth 120 metër kub gaz në vit, mund të digjet ose në fakel ose t'i dërgohet konsumatorit. Unë nuk e di ende arsyen pse nuk ka vajtur te konsumatori, por ky është një problem që zgjidhet.

(Diskutime pa mikrofon)

Sa i takon marrjes së gazit nga jashtë. Faktikisht, siç jua thashë edhe më parë, ne nuk kishim tubacion transmetimi, ndërsa tani jemi para faktit që këtë tubacion e kemi, kështu që gazin do ta marrim nga jashtë. Ne këtu kemi rezerva naftë dhe gazi, por për momentin ato janë në kërkim. Një nga këto është Dumreja ku në 8 kilometra në thellësi pritet, sepse kemi shpuar puse, kolegu im Baftjari e di shumë mirë që janë bërë punime gjeologjike dhe shpime pusesh, të cilat kanë dhënë rezultate. Në perspektivë pritet edhe aty ku është Shpiragu sot, në 15 kilometra distancë, një vendburim tjetër, por këto kërkojnë kohën e tyre. Në projektet që kemi parashikuar kemi lënë pika hyrjeje që kur të prodhojmë gaz të futen në tubacion në mënyrë që të mbulojmë nevojat tona, por edhe të shesim.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Fjalën e ka zoti Bushati.

Më pas zoti Beqiraj.

Helidon Bushati – I nderuar zoti Ahmeti,

Të nderuar përfaqësues të ERE-s,

Është kënaqësi t'ju kemi këtu dhe pa dyshim të marrin në konsideratë atë që ju keni ngritur gjithmonë në këtë komision, jo vetëm sot, por edhe gjatë legjislaturës tjetër, ku në krye të këtij komisioni ishte një kryetar tjetër, duke shprehur disponibilitetin tuaj për të ardhur edhe më shumë se 1 herë gjatë vitit, por gjithmonë keni gjetur një lloj skepticizmi të paargumentuar nga maxhoranca e atëhershme, por edhe e sotmja, megjithatë unë shpresoj që me kryetarin e ri të ketë një ndryshim të përjasje tjetër.

ERE, si Ent Rregullator i Energjisë, jo vetëm këtë moment, por gjithnjë do të jetë një ndër entet vendimmarrja e të cilit do të ketë shumë impakt në jetën e qytetarëve shqiptarë, duke qenë që çmimi i energjisë është nëna që influencon çmimin e të gjitha produkteve të tjera, e impakton aq më tepër sot.

Unë dua t'ju bëj disa pyetje, të cilat besoj se i interesojnë çdo qytetari shqiptar.

Së pari, fenomeni i shumëpërfolur dhe i argumentuar i keqmenaxhimit të kaskadës së Drinit gjatë muajve prill dhe gusht të vitit 2021, objekt i të cilit është edhe raporti që po flasim. Ju na e paraqitët shumë qartë te raporti juaj, por edhe në mënyrë grafike, dhe në të thuhet: “Në muajin prill rezerva energjetike e kaskadës së Drinit ka qenë 1520 GWh,

ndërkohë rezerva energjetike në fund të gushtit është 628 GWh, pra 1/3. Kjo energji është faktuar, sepse ka dokumente, është shitur me 45, maksimumi 50 euro për mega dhe pas gushtit po ky entitet ose më mirë të themi një tjetër sh.a. po shtetërore, OSHEE-ja, ka blerë energjinë që duhet për furnizimin e qytetarëve shqiptarë me 250 euro, pra me pesëfishin e çmimit. Ju këtë e keni paraqitur qartë në grafik dhe në pjesën narrative të raportit tuaj, por do të doja një qëndrim tuajin për keqmenaxhimin e kaskadës së Drinit nga KESH sh.a.

Pyetja e dytë, po ashtu, është një pyetje që u intereson qytetarëve shqiptarë. Kryeministri është ai që u paraprin jo vetëm institucioneve qeveritare, por fatkeqësisht i paraparin edhe ERE-s, edhe ju, por këtu duhet qëndrimi juaj. Kryeministri dhe ministrja e Energjetikës, pa u konsultuar me ERE-n dhe ndryshe nga ajo që kanë deklaruar ndër vite, kërkojnë dhe vendosin rikthimin e fashave për konsumatorin familjar, konsumator i rregulluar dhe përderisa konsumatori është i rregulluar është në fushën e kompetencës së ERE-s. Do të doja qëndrimin tuaj mbi rikthimin e fashave të energjisë për konsumatorin familjar.

Pyetja e tretë ka lidhje me liberalizimin e tregut, një nga detyrat, që ka dalë në raport edhe gjatë diskutimeve me shërbimet e Kuvendit, si detyrë e realizuar, i cili nënkupton ndarjen e OSHEE-së më pas edhe elemente të tjerë që dolën gjatë diskutimeve të parafolësve.

Pyetjet e mia janë: pse sa është ndarë OSHEE-ja në 3 operatorë? Për çfarë duhet OSHEE Group, forma juridike, e cila nuk parashikohet as në legjislacionin shqiptar? OSHEE Group te ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare nuk ekziston si formë juridike.

Përsëri, në këtë kuadër, për se duhet të ekzistojë OSHEE Group apo vetëm për të kryer prokurimet? Ju, pa dyshim, nuk jeni enti që monitoroni prokurimet, por ajo që u fol sot këtu ishte fakti që është hedhur një tender prej 8,3 milionë euro për Smart Meter-s dhe enti prokurues nuk është as FSHU-ja dhe as FTL-ja, por është OSHEE Group. Kjo është pakuptimtë dhe ju duhet të ndërhyni këtu. Kolegu im foli për elemente që lidhen me numrin e punonjësve, pa dyshim që edhe këtë ju e keni në dorë, sepse duke u dyfishuar numri i punonjësve është dyfishuar edhe fondi i pagave nga 29 në 50 milionë euro, ndërkohë që po bëhet investime në vite.

Në vitin 2015 ju keni përcaktuar çmimin e mesatarizuar në 12,7, në mos gaboj, i cili lidhet me nivelin e investimeve, i cili duhet të lidhet pa dyshim edhe me uljen e numrit të punonjësve. Unë mendoj që për këtë problematikë duhet qëndrimi juaj.

Kuadri i liberalizimit është një nga nënpyetjet.

Zoti kryetar, liberalizimi në vetvete ka koncept, nëse hyjnë operatorë të tjerë. Pyetja e drejtpërdrejtë që unë kam është: në vitin 2018 ju i keni licencuar KESH sh.a. edhe me mundësinë për të shitur...

(Diskutime pa mikrofon)

Më falni ta mbaroj pyetjen, e di që e keni licencuar në vitin 2018.

...dhe për të tregtuar për konsumatorin familjar. Pse OSHEE-ja nuk ka lidhur ende kontratë, duke i mohuar kontratën KESH sh.a.-së, entitetit publik, për të shitur për konsumatorin familjar, gjë, e cila mund të sillen një ulje të çmimit, por edhe një të ardhur plus të KESH sh.a? Pse OSHEE-ja bën bllokadë lidhjen e marrëveshjeve me operatorë të licencuar për hyrjen në tregun me pakicë, i cili është një detyrim ligjor? Ky është liberalizimi, zoti kryetar, në vetvete, që në fund konsumatori familjar të ketë mundësi të zgjedhë cilin operator dëshiron, OSHEE-në, KESH sh.a.-në apo një sh.a. tjetër kjo nuk ka rëndësi. Për këto arsye nuk ka ndodhur liberalizimi, ndaj është një detyrë e përlizuar, zoti kryetar.

Pyetja tjetër ka lidhje me një rast që është përfolur në media, rasti i famshëm i lidhjes së kontratës ndërmjet KESH sh.a dhe një subjekti privat për shkëmbim energjie në të plota. Të plota, do të thotë që vjen shumë ujë, nuk mund të mbahet, prandaj ose shkarkohet ose i jepet një operatori.

Disa vite më parë është lidhur një kontratë mes KESH sh.a dhe një prodhuesi termik, i cili ishte njëkohësisht edhe tregtar, duke u kthyer prapa dhe u argumentua që ishte në shkelje të ligjit dhe këtë mënyrë kontrata u prish. Pyetja është: pse u lidh kjo kontratë jo më me një prodhues, i cili kishte mundësi ta kthente energjinë kur ti të kishe nevojë, por tashmë vetëm me një tregtar të mirëfilltë energjie, i cili e blen nga KESH-i dhe ia shet OSHEE-së?

Pyetja tjetër ka përsëri lidhje me këtë element. Ju thatë që KESH-i ka prodhuar këtë vit 5,4 GWh, 3,9 i ka detyrim kontraktual për t'ia dhënë OSHEE-së, ndërsa pjesën prej 1,5 e shet në treg të lirë. Pse nuk keni ndërhyrë ju si Ent Rregullator që të mos ndodhë fenomeni i pakuptimtë, alogjik dhe antiekonomik, ndërkohë që KESH-i në të njëjtën ditë shet me 150 OSHEE-ja blen me 250? Kjo sasi energjie e prodhuar nga KESH-i dhe nga shoqëritë aksionere shtetërore i shitet FSHU-së në rastin konkret, operatorit që furnizon tregun me shumicë.

Po kaloj te furnizuesi i mundësisë së fundit. U fol për çmimin e furnizuesit të mundësisë së fundit, ndërkohë që nga ana e ERE-s ka pasur një thirrje për të aplikuar për përzgjedhje të furnizuesve të mundësisë së fundit, por dështoi si procedurë. Dua një shpjegim, kjo nuk varet nga ju: pse asnjë nga të gjithë të licencuarit nuk u ofrua si furnizues i mundësisë së fundit?

Tjetra, duke e lidhur me pyetjet që bënë kolegët. Gjatë 3 muajve të parë bizneset janë faturuar me 18,8 përpara vendimmarrjes së ERE-s. Dua të di: këto biznese do të duhet të paguajnë edhe diferencën e çmimit të fiksuar nga ERE dhe të asaj që kanë paguar realisht për 3 muajt e kaluar, apo jo?

Pyetja e fundit ka lidhje me gazifikimin. Kjo gjë u diskutua shumë, prandaj nuk dua ta zgjas. Unë di që ka pasur një mungesë të theksuar transparence sa i takon lidhjes që kontratës që u bë para pak muajsh ndërmjet qeverisë shqiptare me Excelerate dhe Exxon. Në fakt, Exxon është një kompani shumë e madhe, por në deklaratat publike të Kryeministrit dhe të ministres së Energjetikës nuk dilte qartë nëse ishte për të importuar gaz apo ishte për vënien në funksion të TEC-it, për rikvertimin e TEC-it me gaz dhe me naftë nga vetëm me naftë që është sot. Dua të di: Excelerate dhe Exxon do të importojnë nga Excellerate dhe Exo, meqenëse kemi 2 PC, 2 milionë metër kub që e kemi si mundësi për t'i marrë nga TAP-i në vetvete, në këto kushte pse duhet një kontratë tjetër kur ne ende nuk harxhojmë asnjë metër kub nga ai që kemi mundësi t'i harxhojmë nga TAP-i? Pse u bë kjo lidhje kontrate, të lutem? Pra, duhet një sqarim dhe informacion sa më i detajuar për sa i përket këtij elementi. Meqenëse i kemi 2 milionë tani del edhe një kontratë e pasqaruar në lidhje me Excellerate dhe Exo. Për çfarë bëhet fjalë.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Fjala për ju.

Petrit Ahmeti - Faleminderit, zoti Bushati!

Është një grup pyetjesh, të cilat fillojnë me pyetje, vazhdojnë me diskutime, pastaj vazhdojnë me pyetje prapë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju falënderoj për pyetjet!

Unë do t'ia jap fjalën sekretarit të Përgjithshëm për një pjesë të pyetjeve.

Elton Radheshi – Lidhur me keqmenaxhimin e kaskadës sistemi energjetik që ne kemi bazohet në hidrot, kur ka reshje është e pamundur të depozitohet, ose do të eksportojë ose do të shesë. Periudha e 6 mujorit të dytë të vitit 2021 ka qenë e thatë, 6 mujori i parë ka qenë periudhë hidrike e mirë.

Për më tepër Enti Rregullator nuk merret me menaxhimin e kaskadës. Ka një grup teknik që merret me menaxhimin e kaskadës. Gjithsesi në raport është paraqitur qartë situata e kaskadës, si rezervë hidrike, si rezerva energjetike. Sa i përket rikthimit të fashave aktualisht ne nuk kemi asnjë aplikim.

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, bëri një pyetje shumë të thjeshtë dhe tha se në muajin prill ndodheshim në këtë kuotë, u shit, dhe në muajin gusht filluam të blejmë me çmime të larta. Pse nuk u ruajt për muajin gusht që ne të mos shitej? Është bërë disa herë kjo pyetje dhe asnjëherë nuk është dhënë një përgjigje e saktë. Pra pse filluam shitjet në prill kur mund të mos shisnim, ta ruanim dhe të mos detyroheshim në gusht ose shtator të blinim me çmime të shtrenjta? Nëse mundeni të jepni një përgjigje të saktë dakord. E kuptojmë që nuk është fusha juaj.

Elton Radheshi – Kur është shitur në prill ka pasur prurje anësore, ishte pamundur që të mbahej. Prill - maj -qershor kanë qenë muaj me prurje. Sa i përket pyetjes se pse është filluar të blihet në gusht, në gusht rritet konsumi dhe edhe prodhimi vendas nuk arrin ta plotësojë të gjithë konsumin, ndaj është e pamundur që të mos blihet. Në prill ne nuk mund ta dinim se mund të rriten çmimet në shtator - tetor, sepse viti 2021 ka qenë një vit atipik sa i përket çmimeve. Pra rritja e çmimit është gati 5-fish në krahasim me vitet e kaluara, pa e krahasuar me vitin 2013 që është viti i pandemisë, që ka qenë edhe më keq më i ulët çmimi. Po të krahasohet mesatarja e blerjeve nga importi është rritur shumë, por efektet kanë ardhur nga tregu rajonal jo na tregu vendas.

Arben Pëllumbi – Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Unë kam një ndërhyrje, sepse Zoti Radheshi, ka një problem, ju jeni specialist për këto gjëra, por problemi është këtu që ka një tabelë regjimesh dhe nga muaji maj deri në shtatorë ju e dini shumë mirë tek rregullorja nuk lejohet nëse nuk kalon mbi 296, nëse nuk gabohet, 296 relative, 295 absolute. Nuk ka qenë në 295 absolute, 296 relative në mënyrë që ju të shisnit dhe, aq më tepër, ta shfrytëzonit kaskadën, mund t'ju jap edhe tabelën e shfrytëzimit të regjimit me mbi 370%, 369%, 377% në prill, 369%, 170% në qershor, është ndaj regjimit të parashikuar me rregullore, po them, prandaj, ju lutem, ose përgjigjuni ose thoni që është një problem i keq menaxhimit nga ana e KESH dhe mund të mirëkuptohet, sepse nuk keni pse mbani çdo lloj barashke të KESH-it ose te OSHE-së OST-së apo kujt do tjetër, por ama mos bëni avokatin mbrojtës të këtyre sh.a-ve që keqmenaxhojnë fondet publike sepse ju e dini shumë mirë që uji në kaskadë është lek.

Petrit Ahmeti – Zoti Bushati kërkoj mirëkuptimin dhe tuajin që avokatinë e KESH-it natyrisht ne nuk i kemi bërë, kemi bërë gjykimin dhe dhënien në mënyrë më transparente në raportin vjetor të të gjithë treguesve që ka pasur kaskada e Drinit. Vetëm një gjë dua që t'ju them, edhe për të sqaruar disi këtë problematikë që vërtetë është shumë e mprehtë, bashkohem me shqetësimin tuaj, por kaskada e Drinit ka një koeficient propabilitar në menaxhimin e saj dhe në resurset që ajo ka. Gjithmonë ky koeficient ka qenë i pranishëm në

shumë vite dhe kanë qenë riciklimet 10 vjeçare që ndodhin në kaskadën e Drinit në këto situata me prurje jashtëzakonisht të mira të cilat pa dashur të shqetësoj dhe abuzoj me procesin kanë sjellë dhe përmytje të zonave të Nënshkodrës, mbi bazën e prurjeve që aktualisht më përpara në muajt e fundit kemi pasur. Unë mendoj se kjo e bën më të justifikuar atë fakt të atij lloj menaxhimi. Ne nuk jemi avokatët e KESH por jemi këtu për të thënë pjesën e logjikshme ose ashtu siç e kemi menduar për atë menaxhim të kaskadës. Edhe ne kemi kërkuar një informacion, në fakt, për mënyrën si është drejtuar kjo kaskadë dhe jemi, si të thuash, në një moment diskutimi, por unë rezervoj të drejtën të them konkluzionet e këtij diskutimi dhe të këtyre monitorimeve që praktikisht ne po bëjmë tek KESH-i, pikërisht për këtë problem procesi, i cili është një proces i ricikluar është i ndodhur dhe në vitet e tjera, por këtë vit mund të quhet edhe më pikant dhe kemi detyrimin për ta analizuar dhe për të dhënë një përgjigje si ent rregullator, sepse në fund të fundit kemi dhe përgjegjësinë e kësaj pune dhe të monitorimit dhe të menaxhimit të kësaj situatë.

Elton Radheshi – Të vazhdoj me të tjerat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa i përket rikthimit të fashave ne nuk kemi asnjë aplikim nga FSHU-ja. Gjithsesi vendimmarrja, nëse do të vijë, do të jetë përsëri e jona, por aktualisht ne nuk kemi asnjë aplikim për rikthimin e fashave. Kështu që unë nuk mund t'i përgjigjem pyetjeve për deklaratat që janë bërë për këtë.

Petrit Ahmeti- Në lidhje me fashën duhet të kemi parasysh një gjë që ne e përdorim fjalën rikthimi i fashave. Ne kemi një eksperiencë në lidhje me problemin e fashave që unë edhe në raportin e vitit të kaluar e kam quajtur të justifikuar atë masë që është marrë dikur për vendosjen e dy fashave që ka qenë e detyrueshme për kufizimin e përdorimit të energjisë elektrike. Por vlera e asaj fashe, që ka qenë deri ne 300 kilovat orë, nuk është më ajo vlerë, por tani është propozimi i dhe diskutimet, është një fashë shumë e lartë gati deri në 700 kilovat orë, në muaj dhe ne tani po bëjmë analizat nga të dhënat që kemi për konsumin familjar për të parë mbi bazën e këtij projekt propozimi, po e quaj, se ende jemi në diskutime, për të parë se sa për qind e popullatës të konsumatorëve zë kjo fashë dhe sa për qind është pjesa e fashës së dytë. Por, gjithsesi këtë dua të sqaroj, edhe zoti Radheshi e cilësoi, ne jemi në një fazë që ende nuk dimë një propozim konkret, por ndërkohë jemi para një situatë që po e analizojmë, përtej faktit të propozimit politik ose vendimit rregullator. Tani zhvillimi i politikave ka qenë gjithmonë dorë për dorë me rregullatoren aq më tepër në këto faza që flasin për situatë të vështira praktikisht energjetike që lidhen qoftë me tregun e huaj qoftë me çmimet brenda vendit.

Elton Radheshi - Në lidhje me liberalizimin e tregut, pyetja kishte të bënte me lidhjet e OSHEE-së grup kur anë tre operatorë të pavarur të licencuar. Tre operatorët e pavarur FTL-ja, OSSH-ja dhe FSHU-ja operojnë në treg si të pavarura me licencë të pavarur.

Marrëdhënia që kanë me OSHE grup janë marrëdhënie bilaterale e tyre, që është e parregulluar dhe skema e OSHEE-së grup, si e tillë, me tri bija, është një skemë që ligji nuk e ndalon, është miratuar dhe ka marrë edhe miratimin e Sekretariatit të Komitetit të Energjisë të Vjenës, si një nga skemat e ndarjes funksionale të tre operatorëve.

Helidon Bushati- Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, nuk është ligj, por ligj organik që rregullon aktivitetin ekonomik të entiteteve ekonomike në territorin e Shqipërisë, si atyre private, publike, mikse, të çfarëdolloj, dhe nuk është vend për të shpikur dhe lexuar ligjin dhe për të thënë që meqenëse nuk është përmendur këtu, unë mund ta bëj. Secili person që ka njohuri bazike për ligjin nuk e interpreton ligjin kështu. Meqenëse nuk është specifikuar ligji nuk e parashikon në asnjë vend, unë po e bëj, aq më tepër që këtij komisioni të nderuar, përfaqësues të ERE-së, jemi ligjvënësit e mandatuar nga votuesit dhe jemi si përfaqësues të maxhorancës edhe të opozitës.

Faktikisht nuk mundet këtu të thotë dikush që krijuam këtë strukturë se na tha sekretariati. Nuk duam të hyjmë në rolin e sekretariatit thjesht konsultues dhe asgjë tjetër, sepse nuk është në deontologjinë e komunikimit me ligjvënës që t'i thoni ka thënë sekretariati. Kjo është në formë sugjerimi. Nuk mund të vini përpara komisionit parlamentar dhe të thoni se ka thënë sekretariati. Sekretariati është ai që është ne e respektojmë, por ka funksionet që ju i dini po aq mirë sa unë dhe që janë funksionet e sekretariatit. Duke u kthyer të përgjigjet meqenëse tani për arsye të borxheve të KESH-it, OSHE-së apo të asaj që rëndom brenda maxhorancës quhet lufta e bërrylave, blerja dhe shitja e energjisë kaloi nga FTL-ja te KESH-i. Tani në këto kushte a ka më sens logjik që FTL-ja të ekzistojë?

Petrit Ahmeti – Zoti Bushati më fal se po kthehem në atë përgjigjen e diskutimit që bëtë më përpara, raporti jonë me Sekretariatit të Vjenës është një raport shumë institucional, është një raport i tillë, sepse është një strukturë e Bashkimit Europian, e cila është prezentë në të gjitha vendet e Ballkanit dhe Mesdheut dhe në një farë mënyrë marrëdhënia jonë nuk ka filluar as dje e as sot, por është një marrëdhënie në vazhdim, në mënyrën më miqësore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, është përfaqësuesi i Bashkimit Europian pranë vendeve të Europës Juglindore, kjo është gjëja që unë mund të them dhe jam i detyruar ta them në këtë komision, sepse ju me të drejtë mund të keni mendimin tuaj, por unë po jap vetëm pozicionin zyrtar nuk kam asnjë element në kuptimin privat apo të institucionit.

Elton Radheshi – Dhe diçka, kur fola për ligjin fola për ligjin e sektorit të energjisë elektrike për ndarjen, jo për ligjin shoqërisë tregtare. Ligji i sektorit të energjisë nuk e ndalon krijimin e grupit dhe për efekt historik dhe kur u krijua fillimisht ndarja e OST-së nga KESH-i në 2004 është bërë po me grup, ka qenë KESH grup që ka marrë dy kompani bija, KESH-in, shpërndarjen dhe OST-në, si logjika ka funksionuar dhe për efekt të ligjit të sektorit sekretariati ka më shumë kompetenca se sa rekomanduese.

Lidhur me liberalizimin e tregut thatë që nuk duket liberalizimi tregut pasi shumica e konsumatorëve nuk janë në treg të lirë.

Aktualisht të gjitha industritë që janë lidhur në tension të mesëm janë në treg të lirë dhe ato që furnizohen si FMF po treg i lirë janë, janë me çmim të rregulluar pasi nuk ka një operator aktual që të furnizojë në treg të lirë por është tregu i lirë. Kjo ka lidhje me pyetjen që bëtë për dështimin e garës së ERRE-s për FMF-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Konsumatori familjar ka të drejtë të dalë në treg të lirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Helidon Bushati – Pyetja ime ishte shumë e artikuluar: A ka licencuar dhe mora një entitet publik, një shoqëri aksionere publike KESH sh.a që është licencuar për t'i dhënë edhe konsumatorit fundor. Dhe nuk lejohet të shkojë tek fundori. Kur është publike, merre me mend kur është private. Tani pyetja ime është shumë e thjeshtë. Nëse unë sot i shpjegoj bashkëshortes të mirat e kalimit nga OSHE t\ë një operator tjetër, a mund të më jepni emrin e dy operatorëve të tjerë sot që unë të shkoj dhe t'i trokas në derë, ju lutem?

Elton Radheshi- Janë po ato operatorë që furnizojnë industritë në treg të lirë. Janë mbi 5 që operojnë, jo të licencuara, se të licencuara ka mbi 30, por që operojnë janë mbi 5.

Helidon Bushati-A to kanë sa i përket 20 kilovoltit 35- shit e të tjera. Unë me bashkëshorten një shpi kemi një apartament kemi dhe OSHE-ja zoti Beci pak ma vonë, ju lutem, se në mes të fjalisë procedura nuk merret me stilistë. Si të duash ti, në daç më dëgjo, në daç mos më dëgjo!

Pyetja është: meqenëse asnjëri prej tyre nuk ka marrëveshje me OSHEE-në, e cila në vetvete nuk jep segmentin e transmetimit deri te shtëpia ime dhe shtëpia e zotit Beci, edhe te shtëpia e secilit prej nesh, këtu dua të dal, jo tek ata që furnizojnë konsumatorët e mëdhenj, që kanë dalë me kohë, apo biznesin, te konsumatori familjar, nëse do të donte të ikte nga OSHEE-ja, të nesërmen a i ndërpritet energjia? Se unë e ndërpres kontratën. Mund të ma shpjegoni? Në qoftë se doni ndihmë nga zoti Beci, pa dyshim, mund t'ia jepni fjalën atij.

Arben Pëllumbi - Për procedurë, fjalën e ka zoti Beci.

Benet Beci – A ka mundësi që kur i sistemojmë pyetjet dhe përgjigjet, unë e kuptoj që bashkëbisedimi ka vlerë, të mos i mbarojmë me shembuj konkretë. Kam përshtypjen se diskutimi merr formën e një gjëje pa racionalitet, por për *show*.

Kështu që, ju lutem, do të kisha sugjeruar që pyetjet të jenë pyetje, edhe Rregullorja e ka, mbarojmë pyetjet dhe më pas u japim mundësinë zotërinjve të japin përgjigjet, se unë nuk mund të dëgjoj se çfarë eksperience ka njëri apo tjetri. Unë mendoj se është e nevojshme të ndahet për ta racionalizuar dhe për t'i dhënë një sens takimit. Këtë desha të thosha, edhe me mirëkuptimin e zotërisë.

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Beci!

Në fakt, ne jemi këtu prej 2 orësh e gjysmë, dhe kështu po e zhvillojmë mbledhjen, pra drejtohen pyetjet pastaj vazhdojmë përgjigjet. Ishte një moment ndërhyrjeje i zotit Bushati, më shumë për të sqaruar e për të qenë precize edhe përgjigja.

Fjala për zotin Ahmeti.

Petrit Ahmeti – Në përgjigje të pyetjes suaj, zoti Bushati, ka disa vite që është miratuar një vendim nga Enti Rregullator, që edhe konsumatori familjar ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin e tij. Pjesa funksionale ka problemet e veta, por meqenëse u bë kjo pyetje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mirëkuptoni atë që po them!

Ajo çfarë po them është se ka një vendim nga Enti Rregullator para shumë kohësh, që edhe konsumatori familjar del në treg të lirë dhe ka të drejtë të zgjedhë furnizuesin e tij. Kjo ka qenë një nga zbatimet e direktivave të BE-së për liberalizimin e tregut, dhe kjo është në fuqi akoma. Mos e ngatërroni me efektin, sepse ana funksionale natyrisht është disi e vështirë, por që ka të drejtë ligjërish, që edhe ju si familje, edhe unë, mund të shkojmë të gjejmë furnizuesin tonë dhe nuk ka asnjë lloj problemi.

Arben Pëllumbi - Keni pyetje të tjera?

Zoti Beqiraj ka pyetje.

Ismet Beqiraj – Edhe herë tjetër e kam thënë dhe përsëri e them, do të respektojmë deri në fund Rregulloren, sepse përgjigje shteruese si më intereson mua apo ndonjë tjetri, asnjëherë nuk mund të marrë.

Ju lutem, po e bëmë që në çdo pyetje të ndërhyjmë sa herë të duam, atëherë jemi jo vetëm jashtë Rregullores, por edhe jashtë rezultatit të mbledhjes dhe të qëllimit që kemi.

Nuk është ky institucioni që do t'u japë përgjigje të gjitha pyetjeve që ngremë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Që këtu po bën gabim! Ke folur sa herë ke dashur pa limit. Si kryesi që jeni, 4 vetë, keni shkelur Rregulloren. Ndaj, ju lutem, kur keni folur ju, unë nuk kam ndërhyrë kurrë që nga dita e parë deri më sot që jam anëtar i këtij komisioni.

Ju lutem, të flasim gjëra racionale! Kështu po bëhemi qesharakë edhe para medias.

Në qoftë se do të bëjmë *show* politik, sigurisht që do të bëjmë politik, por jo në këtë sens.

Arben Pëllumbi - Zoti Beqiraj, nuk e di pse e bëtë këtë ndërhyrje!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani po flas unë, se pikërisht për këtë u ankuat, që kur flet dikush, të mos ndërhyhet!

Kur e filluam këtë mbledhje, ju kërkova mirëkuptim se si do të donit ta zhvillojmë mbledhjen, pyetje-përgjigje, apo të drejtoni pyetjet dhe të kemi përgjigjet në fund dhe të gjithë ratë dakord që do ta bëjmë kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, se si e drejtoj unë këtë komision, mund të bësh vërejtjet e tua, por nuk besoj që deri më sot ka pasur njeri vërejtje. Në qoftë se ke vërejtje, m' i drejto, kështu që do t' i kemi parasysh!

Mos e interpreto Rregulloren siç mund të të interesojë ty! Ajo zbatohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është vendosur e gjithë fjala. Në qoftë se ke nevojë të flasësh, kërkoje fjalën, që besoj se nuk të është mohuar kurrë. Mos bëj aludime që s' të takojnë t' i bësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos më trego mua se cili është realiteti!

Inatet që mund t' i kesh, mos i nxirr këtu në komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam duke e drejtuar siç janë rregullat, dhe këto rregulla i përcakton Rregullorja dhe të gjithë bashkë këtu. Ramë të gjithë dakord se si do ta drejtojmë këtë seancë pyetjesh dhe dëgjese me Entin Rregullator të Energjisë. Në qoftë se nuk e patët vëmendjen ose nuk ishit, se erdhët me vonesë, kjo është çështje tjetër.

Të lutem, më i kujdesshëm herë tjetër!

Fjala për zotin Ahmeti.

Petrit Ahmeti – Në garën që u hap për FMF-në nuk mori pjesë asnjë operator nga ana e ERE-s dhe ne do ta rihapim garën sërish, siç është edhe procedura. Kushtet që ishin vendosur për marrjen pjesë në garë nuk ishin kushte shumë të rënda, çdo operator mund t' i

kapte. Ndoshta pasiguria e çmimit të tregjeve mund të ketë qenë një nga arsyet pse nuk pati asnjë operator të interesuar.

Gjithsesi, rolin e FMF-së aktualisht e mbulon FSHU-ja, meqenëse nuk ka operatorë të tjerë.

Për sa i përket çmimit të industrisë, është faturuar me 18,8 dhe çmimi ka dalë 19,6, kjo do të rakordohet në faturat në vijim. Domethënë, diferenca e çmimit, që është faturuar nga ana e FSHU-së si FMF për tre muaj e parë: janar, shkurt dhe mars, do të rakordohet deri në fund vit, derisa kjo diferencë të zërohet, pasi çmimi i FMF-së në periudhën në vijim për këto industri do të jetë edhe më i ulët.

Një pyetje tjetër ishte: a duhet të ekzistojë FTL-ja? Aktualisht, pasi KESH-i blen importin, FTL-ja sot ka rolin e blerjes së energjisë nga operatorët, aktualisht FTL-ja e blen energjinë nga HEC-et që kanë PPP me FTL-në dhe është e angazhuar me këtë operacion.

Në lidhje me pyetjen pse e blen sot KESH-i, ndërsa dje e blinte FTL-ja, kjo ishte një vendimmarrje e pronarit. Në gjykimin tonë KESH-i e menaxhon më mirë blerjen e importit bashkë me kaskadën që e menaxhon.

Një pyetje ishte për kontratën me një operator për depozitim energjie, kontrata është e parregulluar dhe është jashtë kompetencave të Entit Rregullator. Ka pasur qëndrim si nga Autoriteti i Konkurrencës si nga Enti Rregullator, që për sa kohë KESH-i arrin të mbulojë kërkesën që ka FSHU-ja, çdo pjesë tjetër që ka teprica, i shet në treg të parregulluar, i depoziton apo gjen mënyrën e vet, kjo është pjesa e menaxhimit që kryen korporata dhe nuk ka lidhje me Entin Rregullator.

Arben Pëllumbi - Zoti Bushati, i keni marrë të gjitha përgjigjet?

(Helidon Bushati flet pa mikrofon.)

Petrit Ahmeti – OSSH-ja në rolin e operatorit të sistemit, KESH sh.a është licencuar për veprimtarinë e furnizimit nga Enti Rregullator. Më tej OSSH-ja dhe KESH-i do të lidhin një marrëveshje për shërbimin e shpërndarjes dhe një marrëveshje për shërbimin e transmetimit. Modalitetet e marrëveshjeve i përcaktojnë operatorët. Ne nuk jemi në dijeni nëse OSSH-ja dhe KESH-i nuk kanë lidhur një marrëveshje sa i përket shërbimit të shpërndarjes, por çdo i licencuar ka të drejtë dhe çdo operator ka detyrë të lidhë marrëveshje me çdo të licencuar që ka licencën e furnizimit.

Maksim Shuli - Zoti Bushati, faleminderit për pyetjen!

Faktikisht, lidhur me gazin, po bëhet një studim fizibiliteti nga *excellerate*

për projektin që diskutojmë ne. Në këtë studim janë parashikuar: rinovimi i TEC-it, është linja që do të ndërtohet, është TAP-i dhe në market testin që po bëjmë si TAP, ku janë

tre vende: Greqi, Itali dhe Shqipëri është kërkuar 1,8 Bisiem të futen në tubacion. Kjo do të thotë se pas përfundimit të studimit të fizibilitetit, patjetër do të shtohet një kontratë, sepse kemi të bëjmë me kompani të fuqishme “*ExxonMobil*” që janë bashkuar të dyja prej 10 vjetësh dhe “*Excellerate*”, që është pjesë e tyre. Pas kësaj kontratën do ta miratoni ju në komisionin tuaj.

Mund të them një gjë, në qoftë se çmimi sot në Europë është 30 euro, në Amerikë është 3, domethënë 10 herë më i madh. Amerika prodhon 935 Bisiem, nga këto, 200 Bisiem janë gaz shell, që nuk ka ndotje fare. Bëhet fjalë pikërisht për këtë lloj gazi të lëngët, që do të vijë nëpërmjet anijeve, minus 162 gradë. Pastaj se si do të dalë studimi i fizibilitetit, do të qëndrojë anija, do të ndërtohet terminali, nuk e dimë. Por përderisa kanë kërkuar të injektojnë gaz në rrjet, është ideja e tubacionit Jon-Adriatik nga 5 parashikohet të shkojë 7 deri në 10 bisiem. Besoj se me mbarimin e fizibilitetit, do të jetë çdo gjë transparente.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit!

Fjala për zotin Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Unë kam disa pyetje. Në radhë të parë, ju falënderoj edhe për durimin, por edhe për përgjigjet shpëruese për një sërë çështjesh shumë të rëndësishme që lidhen me energjinë, që është gjaku i ekonomisë dhe nevojë e padiskutueshme e gjithë konsumatorëve.

Në kushtet e krizës energjetike, mendoni se duhet të incentivohen aktorët që prodhojnë energji elektrike duke u bazuar në burimet energjetike ekzistuese fosile që ka vendi ynë pavarësisht kostos? Sot ne e dimë sa është çmimi i energjisë elektrike në bursë. Nga ana tjetër, ka edhe mungesë të prodhimit për të përballuar këtë çmim të lartë që buxheti i shtetit po kompenson te qytetarët dhe te biznesi, sepse, duke ditur që pesha totale e energjisë fosile që konsumon Shqipëria në vit zë gati 64-65%, të lësh këtë sektor në hije më duket që është një komoditet dhe luks i madh në këto ditë krize, flas më shumë për naftën bituminoze, ose zhavorrin bituminoz, për qymyrin e të gjitha llojeve që kemi nga e cila të vjelim energji.

Zoti Shuli foli për TEC-in: mendoni që do të ketë një TEC të ri me gaz natyror apo do të ketë një rehabilitim të teknologjisë së TEC-it ekzistues të Fierit, që ka qenë një nga balancuesit kryesor të rrjetit kombëtar të energjisë? Në këto kushte, pse nuk vihet në punë, se nuk do të presim sa të bëhen projekte e studime?

Edhe zoti Nustret e bëri pyetjen, por edhe unë do ta përsëris: ne kemi aq sa prodhojnë burimet natyrore të gazit në Shqipëri, qoftë edhe i Delvinës që është më aktiv, që ka edhe gaz kondensat, por një burimet shumë të rëndësishme është edhe gazi shoqëruar i naftës. Në këtë

tavolinë të paktën 3 veta jemi specialistë të kësaj fushe, sot hidhet në natyrë nga të gjitha kompanitë dhe operatorët që kanë veprimtari në sektorin e nxjerrjes dhe të prodhimit të naftës bruto duhet të planifikohen dhe të merren masa, minimalisht të furnizohen serrat në zonat naftëmbajtëse të qarqeve: Fier, Berat dhe Vlorë, siç janë furnizuar, sepse po digjet energji dhe aty ku po lëshohen të paoksiduar, po helmohen.

Ndoshta është menduar, por në këto kushte krize nuk dëgjova që duhet t'i shfrytëzohet me nikoqirllëk, siç thotë populli, burimet energjetike të rinovueshmet, ujin dhe prodhimet, të mos i shpërdorohet ose të investohet te sektorë, që ndikojnë direkt në humbjen e energjisë, që të mos ndalen, por të vazhdojnë prodhimin.

Për shembull, propozoj të vazhdojnë investimet për zëvendësimin e rrjetit të abandonuar të viteve '68, '69, të rrjetit shpërndarës deri te konsumatori fundor, i cili po bëhet me sistem kabllor.

Për sa i përket gazit natyror, që për fat kalon në vendin tonë, është bërë aktive premio që fitojmë nga kjo? Fiton Shqipëria? Në vitin 2021 është transportuar gaz. A ka filluar të shkojë kjo premio 80 e ca milionë euro pas rinegocimit të kontratës për këtë vit në buxhetin e shtetit, vetëm si qira për kalimin?

Jam plotësisht dakord me masterplanin e bërë në mënyrë, që e sqaroi me detaje edhe zoti Shuli, por kur do të fillojë konkretisht gazifikimi? Është bërë projekti i daljes së gazit në Seman? Në cilën fazë është? A është i gatshëm ta shpërndajë në rrjetin "IAP"? Është i gatshëm për gazifikimin e Shqipërisë? Qarkun e Fierit e prek, si konsumatorin privat, edhe operatorët e prodhimit bujqësor, industrinë agro-bujqësore dhe industriale, për duhet parë mundësia që ky gaz të furnizojë jo vetëm industrinë dhe të kursejë lëndët energjetike, por të furnizojë edhe industrinë e prodhimit të plehrave kimike dhe azotike, nitrat dhe ure. Nitrat dhe urea u shkatërruan në Fier, sepse nuk kishte gaz natyror, por tani që gazi erdhi, qeveria duhet të incentivojë iniciativa private për ndërtimet e uzinave të prodhimit të plehrave azotike, që sot nuk ka.

Një problem tjetër lidhet me diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, që janë fotovoltaike, ERE-s dhe biomasës. Për biomasën nuk flitet fare, por edhe kur flitet për investimet e bëra për TEC-et, në impiantet e trajtimit të mbetjeve, quhen investime herezi, sepse biomasë është lënda organike që vete atje, por nuk e kalojnë në atë linjë dhe nuk e diskutoj, ndërsa diversikimi i burimeve të rinovueshme dhe iniciativa e aktorëve të ndryshëm ka barriera ligjore juridike për fuqinë e instalimit. Në këto kushte, sepse m'u duk sikur dëgjova se do të përmirësohet kuadri ligjor, por a është e vërtetë që ka barriera për fuqinë e instalimit? Nëse bëhet një impiant fotovoltaike deri në këtë nivel fuqie, jo më lart, a është

mundësia e liberalizimit dhe e garantimit të tregut për t'u futur në rrjetin e shpërndarjes dhe të konsumit?

Arben Pëllumbi – Fjala për ju, zoti Ahmeti.

Petrit Ahmeti – Pyetjet ishin të diversifikuara dhe përgjigjet do të jetë të diversifikuara, sipas disiplinës dhe profilit.

Një pjesë e pyetjeve, që lidhen me politikën e zhvillimit të sektorit, me zhvillimin e gazit natyror janë projekte të dikurshme, që natyrisht kanë nevojë të rizgjohen apo të trajtohen.

Për sa i përket përdorimit të energjisë elektrike nga energjia diellore, ka një ligj që përcakton kufijtë me të cilët jepet e drejta e instalimit të impianteve që ndajnë fuqinë 2 mega, për të cilën ne si institucion kemi të drejtën për vendosjen e çmimeve për tregun e rregulluar, ndërsa për kapacitetet mbi 2 mega do të dalin në treg të lirë.

Dua të sqaroj që në fillim, se ne mund të futemi në një përgjigje të gjatë dhe shteruese, por pozicioni i Entit Rregullator është për të përcaktuar çmimin e energjisë elektrike mbi bazën e disa metodikave, që ne i kemi të miratuara. Liberalizimi i këtij tregu, qoftë nga pikëpamja e fuqisë së instaluar, edhe nga e drejta e përdorimit të tyre, lidhet me qeverinë, e cila ka përcaktuar ligjin dhe të drejtën për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centraleve fotovoltaike.

Për pyetjet në lidhje me sektorin e gazit natyror, po ia kaloj fjalën kolegut Shuli.

Maksim Shuli – Për të përdorur burimet fosile, duhet të kesh TEC-in. Ju përmendët se mund të përdorim rërën bituminoze. Ne dikur e kemi përdorur rërën bituminoze për të prodhuar bitumin, të cilin e çonim në TEC, por ne nuk kemi TEC dhe del kosto shumë e lartë, ndaj jemi të detyruar të bëjmë një studim fizibiliteti për të përdorur qymyrin, që e kemi të varfëruar. Me sa di unë, në Tiranë punonte me 1200-2000 kilo/kalori për kilogram/gradë, ndërkohë që bota i ka qymyrët me 8000. 1200-2000 janë argila, që e ndotit shumë mjedisin.

Në kushtet aktuale ne kemi prioritet të vendosim TEC-in, siç është dhe pyetja e juaj e dytë. TEC-i i ndërtuar ishte faktikisht me D2 (dizel marinë), rreth 162 mijë tonë prodhojnë 80 deri në 100 mega në vit, aq sa ne importojmë sot. *Exxcelerate* ka marrë përsipër të rinovojë TEC-in që është aktualisht, do ta kthejë me gaz, sepse nuk ka ndotje. Shell gaz do të vijë direkt nga Amerika.

Gazi shoqëruar me naftë është në sasi të vogla, përdoret për konsum vetjak, aty ku prodhohet naftë, përdoret në kaldajë, siç edhe ju e dini. Ministria e linjës ka në varësi Agjencinë Kombëtare të Hidrokarbureve, që duhet ta monitorojë dhe të shikojë se ku qëndron problemi, sepse ne, si Enti Rregullator i Energjisë, caktojmë çmimin e gazit, por nuk marrim

masa që ky gaz të shkojë atje ku duhet, ndaj ministria e linjës, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore ka të drejtë të monitorojë dhe të vendosë detyrat për të ardhmen.

Në lidhje me gazin natyror, unë e përmenda pak më parë, ka 3 vendime të enteve rregullatore në vitin 2013: Shqipëri, Greqi dhe Itali. Sekretariati i energjisë ka dhënë një mendim më 14 maj të vitit 2013, ku ka miratuar përjashtimet si vend kandidat dhe më 16 maj 2013 Komisioni European ka vendosur të përjashtohen. Çfarë përjashtohet? Unë do të përmend vetëm dy raste: në Shqipëri kanë vendosur kusht që do të kalojë tubacioni dhe t'i mund të marrësh gaz sa të duash. Ky është përfitim i madh. Sa do të marrësh? Nga 2 miliardë deri në 10 miliardë. Pra, ka bërë përjashtim jo se do të kalojë tubacioni dhe ti do të marrësh leje, por sa herë të kërkosh, ke të drejtë ta marrësh sasinë e gazit. Po ashtu janë lënë pikat ekzistuese. Për shembull, është lënë një tub 24-polësh në Kuçovë, me idenë që nga Kuçova të shkojë në Dumre, dhe të bëhet depozitimi i gazit natyror për të gjithë rajonin, jo vetëm për Shqipërinë, pasi Greqia dhe Italia nuk mund të bëjnë *storag-e*, ndaj do ta bëjmë ne depozitimin e gazit. Pikërisht këtu qëndron mrekullia që po vjen nga “*ExxonMobile*” dhe “*Exxcelerate*”, sepse e shikojnë si një burim diversifikimi dhe furnizimi të Europës, sepse, duam apo nuk duam ne, ata janë prodhuesit më të mëdhenj të botës dhe ky tubacion bën që ne të jemi të domosdoshëm dhe të përfitojmë.

Tjetra, janë bërë tolerime. Autoritetet rregullatore duhet të jenë përgjegjëse për caktimin e miratimit të metodologjive të nevojshme për të përcaktuar tarifën. Pra, me tubacionin do të lidhet një privat apo një tjetër dhe ne do të përcaktojmë tarifën.

Për aksesin e rrjeteve kombëtare, ne do të caktojmë një tarifë për gazin e lëngëzuar. Pra, e kemi ne në kompetencë. Këto rregulla i ka vendosur Komisioni European.

Ofrimi i shërbimit të balancimit

Nga ana e energjisë elektrike, kolegët e mi e dinë shumë mirë që po hiqen tarifat, po vendoset të shkojnë te konsumatori fundor. Paketa 4 e energjisë është për mbështetjen e konsumatorit, mundësisht me lidhje direkte. Pra, janë hequr një mori masash. Problemi nuk është se ne do të fitojmë shumë. Unë e përmenda pak më parë tarifën *fee*, për të cilën në medie flasin kot, pa ditur gjë, është 0,3 euro për 1000 metër/kub për 100 kilometër, 5 milionë euro në vit.

A e dini se sa kemi marrë ne deri tani? Ne kemi marrë pikën e hyrjes në Fier, që është rreth 12 milionë euro. Pra, atë që po ndërtohet me investimet e TAP-it të aksionarëve, ne e marrim falas. Ne kemi marrë 5 milionë euro për komunitetet, ndër të cilat: 24,7 kilometër rrugë të reja, 136,2 kilometër riparime rrugësh, 41 riparime urash dhe 2 ura të reja.

Gjithashtu, kanë investuar për studimin e fizibilitetit të gazifikimit të Shqipërisë.

Mendoj se përfitimet tona janë disa herë më të mëdha, aq më tepër në kushtet e tanishme, ku furnizimi me gaz rus bie poshtë.

Arben Pëllumbi – Zoti Beqiraj, keni pyetje të tjera? Nuk keni.

Zoti Ahmeti, ju falënderoj ju dhe të gjithëve që ju shoqëruan!

Do të kemi një seancë tjetër për çështjen e përgatitjes së rezolutës.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA